



---

# Çështjet e sigurisë, punësimit dhe zbatimit i ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe ligjit kundër diskriminimit në Kosovë

---

Raport  
FDH Kosovë  
Prill 2008



## **Përmbajtja**

<b>Vërejtjet hyrëse .....</b>	<b>5</b>
<b>Rezyme.....</b>	<b>6</b>
<b>Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore .....</b>	<b>10</b>
1.1. Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë .....	10
1.2. Ligji për përdorimin e gjuhëve .....	11
1.3. Ligji kundër diskriminimit.....	12
<b>Regjioni i Prishtinës/Priştina .....</b>	<b>13</b>
1. Serbët në Prishtinë/Priştina deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës .....	13
1.1 Serbët në Prishtinë/Priştina pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	13
1.2 Serbët në Shërbimin Policor të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës .....	14
1.3 Serbët në Hekurudhat e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	15
1.4 Serbët në Shërbimin Korrektues të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë të Kosovës .....	15
1.5 Serbët në doganat e UNMIK-ut pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	16
1.6. Serbët në KEK pas shpalljes së pavarësisë të Kosovës.....	16
1.7 Serbët në PTK pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës .....	16
1.8 Serbët në Aeroportin e Prishtinës/Priştina pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës .....	17
2. Serbët në Fushë Kosovë/Kosovo Polje deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës .....	17
2.1 Serbët në Fushë Kosovë/Kosovo Polje pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	18
3. Romët në Fushë Kosovë/Kosovo Polje deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës.....	18
4. Serbët dhe romët në Plemetin/Plemetine deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës .....	19
4.1 Serbët dhe romët në Plemetin/Plemetine dhe Obiliq/Obilić pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	20
<b>Regjioni i Prizrenit/Prizren.....</b>	<b>21</b>
1. Turqit në Prizren/Prizren dhe Mamushë/Mamuša .....	21
2. Goranët dhe boshnjakët në Dragash/Dragaš .....	22
3. Serbët në fshatin Mushnikovë/Mušnikovo deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës.....	24
3.1 Serbët në Mushnikovë/Mušnikovo dhe Prizren/Prizren pas shpalljes së pavarësisë .....	24
<b>Regjioni i Gjilanit/Gnjilane .....</b>	<b>24</b>
1. Serbët në komunën e Gjilanit/Gnjilane dhe fshatin Babushi Serb/Srpski Babuš deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës.....	24
1.1 Serbët në komunën e Gjilanit/Gnjilane dhe fshatin Babushi Serb/Srpski Babuš pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës .....	26
1.2 Serbët në komunën e Novobërdës/Novo Brdo pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	26
1.3 Serbët në komunën e Kamenicës/Kamenica pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	27
2. Romët në lagjen Avdullah Presheva/Avdulah Preševa në Gjilan/Gnjilane .....	27
3. Turqit në Gjilan/Gnjilane .....	28
4. Shqiptarët në komunën e Shtërpçës/Štrpce deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës .....	29
4.1 Shqiptarët në komunën e Shtërpçës/Štrpce pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	30

<b>Regjioni i Mitrovicës/Mitrovica</b> .....	<b>30</b>
1. Shqiptarët në komunat Zubin Potok/Zubin Potok dhe Leposaviq/Leposavić deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës.....	30
1.1 Shqiptarët në komunat Zubin Potok/Zubin Potok dhe Leposaviq/Leposavić pas shpalljes së pavarësisë .....	31
2. Serbët në fshatin Bajë/Banja deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës .....	32
2.1 Serbët në fshatin Bajë/Banja pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	32
3. Romët dhe Ashkalinjtë në Mitrovicë/Mitrovica.....	33
4. Boshnjakët në Mitrovicën/Mitrovica jugore dhe veriore .....	34
 <b>Regjioni i Pejë/Peć</b> .....	<b>35</b>
1. Serbët në fshatrat Bellopojë/Belo Polje dhe Dërsnik/Drnsnik deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës.....	35
1.1 Serbët në fshatrat Bellopojë/Belo Polje, Dërsnik/Drnsnik dhe Vide/Vidanje pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës .....	36
2. Boshnjakët në fshatin Dobrushë/Dobruša.....	37
 <b>Qëndrimet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës nga radhët e komuniteteve pakicë</b> .....	<b>38</b>
1. Deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës.....	38
2. Deputetët turq në Kuvendin e Kosovës.....	38
3. Deputetët boshnjakë në Kuvendin e Kosovës .....	39
4. Deputetët romë në Kuvendin e Kosovës .....	40
5. Deputetët egjiptas në Kuvendin e Kosovës.....	41
6. Deputetët goranë në Kuvendin e Kosovës .....	41
 <b>Rekomandime</b> .....	<b>42</b>

# Çështjet e sigurisë, punësimi dhe zbatimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe ligjit kundër diskriminimit në Kosovë

Raport FDH Kosovë Prill, 2008

## Vërejtjet hyrëse

Në periudhën prej janarit deri në fund të prillit të vitit 2008, Fondi për të Drejtën Humanitare – Kosovë (FDH - Kosovë) realizoi një hulumtim i cili sa u përket temave që shqyrton mund të ndahet në dy periudha: periudha e parë, prej janarit deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008 dhe periudha e dytë, prej shpalljes së pavarësisë deri në fund të prillit të këtij viti. Hulumtimi i FDH-Kosovë gjatë periudhës së parë kishte për qëllim të vlerësojë: nëse të gjithë qytetarët e Kosovës gëzojnë në të njëjtën masë lirinë e lëvizjes; nëse kanë qasje në organet komunale dhe institucionet tjera kosovare; a zbatohen dispozitat e ligjit mbi përdorimin e gjuhëve dhe ligjit kundër diskriminimit; cilat janë institucionet shëndetësore të cilave u drejtohen qytetarët e Kosovës; a janë të kënaqur me shërbimet që i ofrojnë ndërmarrjet publike; dhe a respektohet e drejta e qytetarëve të Kosovës për t'u informuar në gjuhën amtare. Në periudhën pas 17 shkurtit 2008, FDH - Kosovë ka hulumtuar kryesisht pikëpamjet e serbëve në lidhje me lirinë e lëvizjes, nëse dhe në çfarë mase përfaqësuesit e pakicave kombëtare i kanë lëshuar vendet e tyre të punës, çka kanë ndërmarrë institucionet e Kosovës në lidhje me këtë dukuri dhe sa është numri i pjesëtarëve të pakicave kombëtare që janë kthyer në vendet e tyre të punës.

Në hulumtim janë përfshirë të gjitha regjionet e Kosovës. Në regjionin e Prishtinës/ Prishtina është marrë mendimi i pjesëtarëve të pakicave kombëtare në komunat Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Obiliq/Obilić. Komunitetet e përfshira në hulumtim në këtë regjion ishin serbët dhe romët. Në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica janë hulumtuar pikëpamjet e shqiptarëve dhe serbëve në komunat Leposaviq/Leposavić, Zubin Potok/Zubin Potok dhe Skenderaj/Srbica. Në regjionin e Pejës/Peć, FDH – Kosovë ka hulumtuar mendimin e serbëve dhe boshnjakëve në komunat e Pejës/Peć dhe Klinës/Klina. Në regjionin e Prizrenit/Prizren, në komunat Dragash/Dragaš, Mamushë/Mamuša dhe Prizren/Prizren, janë marrë opinionet e serbëve, turqve, boshnjakëve dhe goranëve. Në regjionin e Gjilanit/Gnjilane, FDH – Kosovë ka hulumtuar mendimin e serbëve, shqiptarëve dhe turqve në komunat Gjilan/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac, Novobërdë/ Novobrde<sup>1</sup>, Kamenicë/Kamenica<sup>2</sup> dhe Shtërpçë/Štrpce.

Një segment i veçantë i raportit ka të bëjë me qëndrimet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të cilët vijnë nga radhët e komuniteteve pakicë në lidhje me situatën e sigurisë dhe zbatimin e ligjeve që mbrojnë të drejtat e pakicave.<sup>3</sup>

Qëllimi i FDH – Kosovë ishte të pasqyrojë në mënyrë të dokumentuar shkallën e integritetit të pakicave, të tregojë nivelin e implementimit të ligjit mbi përdorimin e gjuhëve dhe ligjit kundër diskriminimit nga këndvështrimi i komuniteteve pakicë dhe të vlerësojë nëse në Kosovë ekziston liria e lëvizjes për

1 Hulumtimi ka të bëjë vetëm me periudhën prej shpalljes së pavarësisë deri në fund të prillit të vitit 2008.

2 Hulumtimi ka të bëjë vetëm me periudhën prej shpalljes së pavarësisë deri në fund të prillit të vitit 2008.

3 Hulumtimi ka të bëjë vetëm për periudhën deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt të vitit 2008.

të gjitha bashkësitë etnike, duke u bazuar në mendimet e shprehura nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë. Gjithsej janë bërë 79 intervista: 28 intervista me serbë, 27 me shqiptarë, 6 me turq, 8 me boshnjakë, 2 me goranë, dhe 8 intervista me romë, ashkali dhe egjiptas.

## Rezime

Sipas të dhënave të misionit të OSBE-së<sup>4</sup>, pakicat kombëtare përbëjnë rreth 10 për qind të banorëve të Kosovës. Serbët përbëjnë numrin më të madh të komuniteteve pakicë (5.32 për qind), pastaj romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit (1.72 për qind), boshnjakët (1.25 për qind), goranët dhe turqit (me nga 0, 70 për qind).

Në bazë të hulumtimit të FDH – Kosovë del se turqit, boshnjakët, ashkalinjtë dhe egjiptasit në përgjithësi janë të integruar në shoqërinë kosovare, mirëpo gjatë periudhës së shqyrtuar nuk është vërejtur ndonjë përmirësim i dukshëm në integrimin e serbëve dhe romëve.

Të drejtat e pakicave vazhdojnë të shkelen çdo ditë. Institucionet e Kosovës nuk i kanë ndërmarrë të gjitha masat për të parandaluar shkeljen e të drejtave themelore dhe zbatimin e plotë të ligjit mbi përdorimin e gjuhëve dhe ligjit kundër diskriminimit.

Problemi më i madh i të gjitha komuniteteve në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe shqiptarët, është papunësia. Përkundër përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës që t'i respektojë dispozitat ligjore, që kanë të bëjnë me punësimin e pakicave në institucionet të cilat janë në kompetencë të saj, pakicat akoma nuk kanë përfaqësim proporcional me numrin e tyre në institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës, e as në ndërmarrjet publike. Mosnjohja e gjuhës shqipe paraqet edhe një pengesë shtesë në punësimin e pakicave dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare. Kur jemi te gjuha, turqit janë në pozitë më të mirë, sepse pothuajse të gjithë turqit e flasin gjuhën shqipe. Ashkalinjtë dhe egjiptasit gjuhën shqipe e kanë gjuhë amtare. Vetëm një numër i vogël i boshnjakëve, goranëve, serbëve dhe romëve e njohin gjuhën shqipe.

FDH – Kosovë ka identifikuar raste kur pjesëtarët e pakicave kombëtare nuk kanë mundur të punësohen pikërisht për shkak të mosnjohjes së gjuhës shqipe.

Pjesa më e madhe e serbëve janë të punësuar në institucionet paralele të Qeverisë së Serbisë, të cilat funksionojnë në Kosovë, si dhe në objektet që janë nën kontrollin e tyre. Sa i përket punësimit në institucionet kosovare, serbët kryesisht punojnë në institucionet e Kosovës në nivel qendror dhe lokal, dhe në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK). Një numër i vogël i serbëve janë të punësuar në ndërmarrjet publike dhe atë në radhë të parë në KEK dhe PTK. Inkurajues është fakti se serbët kanë filluar të punësohen në qendrat shëndetësore të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, gjë që nuk ka ndodhur më parë dhe ka qenë vështirë të bëhet për shkak të prezencës së institucioneve të njëjta paralele të Qeverisë së Serbisë; kështu për shembull, në Shtëpinë e shëndetit në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, pak kohë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës u punësuan 15 serbë. Asnjë nga ata nuk u kthye në punë pas 17 shkurtit. Megjithatë, në shkollat që janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës dhe në ndërmarrjet në pronësi të shqiptarëve, akoma nuk ka asnjë serb të punësuar.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës ndikoi më së shumti që serbët t'i lëshojnë vendet e tyre të punës në institucionet e Kosovës. Edhe Qeveria e Serbisë ushtroi presion mbi serbët që ata t'i lëshojnë vendet e tyre të punës, në institucionet që janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës. Dy javët e para pas 17 shkurtit të vitit 2008, pothuajse asnjë serb nuk u paraqit në vendin e vet të punës. Disa pre tyre morën pushim deri në fund të marsit. Megjithatë, javën e tretë pas shpalljes së pavarësisë, serbët kanë filluar të kthehen. Përkundër kësaj, numri më i madh i serbëve që kanë punuar në institucionet kosovare siç janë komunat, SHPK-ja, Hekurudhat e Kosovës, Doganat e UNMIK-ut dhe Shërbimi Korrektues, akoma nuk janë kthyer në punë. Në disa komuna, si për shembull në Prishtinë/Priština, Pejë/Peć, Prizren/Prizren, Klinë/Klina, Ferizaj/Uroševac, Skenderaj/Srbica, serbët nuk e kanë bojkotuar punën dhe rregullisht kanë shkuar në vendet e tyre të punës. Megjithatë, në shumicën e rasteve serbët nuk punojnë në ndërtesat e kuv-

endeve komunale që ndodhen në qytete, por në zyrat për komunitete të cilat ndodhen brenda enklavave serbe. Shërbimet e burimeve njerëzore të ndërmarrjeve publike të PTK-së, KEK-ut dhe Aeroportit të Prishtinës/Prishtina, nuk kanë të dhëna se ndonjë nga pjesëtarët e bashkësive etnike e ka lëshuar punën pas shpalljes së pavarësisë. FDH – Kosovë, gjithashtu ka konstatuar se romët në Kuvendin e komunës së Novobërdës/Novo Brdo dhe boshnjakët në doganat e UNMIK-ut, janë solidarizuar me serbët duke bojkotuar punën. Institucionet në të cilat serbët, romët dhe boshnjakët e bojkotojnë punën kanë reaguar në mënyrë të njëjtë: punëtorët që nuk lajmërohen në punë akoma konsiderohen të punësuar, por marrin të ardhura të zvogëluara. Ky zvogëlim i rrogës silltet prej 50 deri në 30 për qind. Në disa institucione, të gjithë atyre që bojkotojnë punën nuk do t'u paguhen mëditjet për ditët që kanë munguar.

Në territorin e komunës së Novobërdës/Novo Brdo, në fshatin Prekoc/Prekovce, është shënuar rasti i hapjes së kuvendit komunal si institucion paralel, i cili do të jetë në kompetencë të Qeverisë së Serbisë.

Turqit dhe boshnjakët janë të punësuar në të gjitha institucionet kosovare, si në ato që janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, ashtu edhe dhe në komplekset industriale private. Nuk është shënuar ndonjë rast që turqit t'i kenë lëshuar vendet e tyre të punës pas shpalljes së pavarësisë. Me përjashtim të tre boshnjakëve të përmendur më lartë, të cilët janë solidarizuar me kolegët e tyre serbë të doganave të UNMIK-ut, asnjë boshnjak tjetër nuk e ka lëshuar punën pas 17 shkurtit të vitit 2008. Goranët punojnë si në institucionet e Qeverisë së Serbisë në Kosovë, ashtu edhe në institucionet e Qeverisë së Kosovës. Si në rastin e turqve, asnjë i punësuar nga këto bashkësi etnike nuk e ka lëshuar punën pas shpalljes së pavarësisë. Për sa i përket punësimit, në pozitë më të keqe janë romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, të cilët kryesisht janë raste sociale. Të punësuarit nga këto bashkësi etnike punojnë në institucionet në kompetencë të Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Kosovës, por kryesisht bëjnë punë ndihmëse. Nuk ka pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali apo egjiptas në pozita udhëheqëse. Pas 17 shkurtit të këtij viti, vendet e punës i kanë lëshuar vetëm romët e punësuar në komunën e Novobërdës/Novo Brdo.

Gjatë periudhës të parë të hulumtimit, deri më 17 shkurt 2008, FDH – Kosovë ka shënuar përparim të

përgjithshëm në drejtim të përmirësimit të shkallës së sigurisë dhe lirisë së lëvizjes, për të gjitha bashkësitë etnike. Institucionet e Kosovës publikisht janë përpjekur për integrimin e bashkësisë serbe në shoqërinë kosovare. Për këtë qëllim është formuar Komisioni për gjuhët, në bazë të ligjit mbi përdorimin e gjuhëve, në maj të vitit 2007, kurse në shkurt të vitit 2008 është formuar zyra për komunitete, në kuadër të zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës. Kryetar i zyrës për pakica është vet Kryeministri. Qeveria e Kosovës ka ndarë një milion euro buxhet për këtë zyrë gjatë vitit 2008. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, pozita e serbëve për sa i përket sigurisë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të dukshëm. Prej 17 shkurtit deri në fund të prillit 2008, nuk ka ndodhur asnjë incident ndëretnik. Serbët akoma mund t'i kryejnë të gjitha punët administrative në institucionet e Kosovës, madje disa prej tyre, siç është rasti me serbët e regjionit të Prizrenit/Prizren, kanë filluar ta shfrytëzojnë transportin publik për qarkullim. Megjithatë, FDH – Kosovë ka vërejtur se, në përgjithësi, serbët ndihen të pasigurt pas 17 shkurtit, madje edhe ata që në fillim e kanë bojkotuar e që më vonë janë kthyer në punë.

Në ndjenjën e frikës që mbretëron te serbët ndikim të madh ka Qeveria e Serbisë, e cila vazhdon të insistojë në funksionimin e institucioneve paralele në Kosovë: të shkollave, fakulteteve, ambulancave dhe komunave, si dhe që serbët të mos marrin pjesë në jetën politike të Kosovës. Në veçanti është vërejtur ndikimi negativ i Qeverisë së Serbisë pas shpalljes së pavarësisë të Kosovës, në radhë të parë duke insistuar që serbët t'i lëshojnë vendet e tyre të punës në institucionet të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës. Nga ana tjetër, veprimet e pamjaftueshme të institucioneve të Kosovës dhe incidentet sporadike, siç ishte rasti i hedhjes së mjetit eksploziv në shtëpinë e serbit Robert Savić nga Obiliqi/Obilić, në dhjetor të vitit 2007, ndikojnë në vazhdimin e mbizotërimit të frikës te pjesëtarët e komunitetit serb. Për këtë arsye, serbët akoma shumicën e punëve të tyre administrative i kryejnë përmes zyrave për komunitete, që janë të vendosura në fshatrat e tyre; tregtinë e bëjnë në Graçanicë/Gračanica, Shtërpçë/Štrpce dhe komunat veriore të Kosovës, dhe me përjashtim të serbëve të regjionit të Prizrenit/Prizren, fare nuk e shfrytëzojnë transportin publik kosovar, por udhëtojnë me taksitë e pronarëve serbë, të cilat kushtojnë shumë më shtrenjtë. Serbët gjithashtu i shfrytëzojnë edhe autobusët e UNMIK-ut për transport. Kjo gjendje vazhdon të mbretërojë edhe pas 17 shkurtit të 2008-ës.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, pasiguria e serbëve është rritur edhe për shkak të ndërprerjes të qarkullimit të »Trenit të lëvizjes së lirë«. Ky tren ishte mjeti më i sigurt dhe më i lirë i transportit, përmes të cilit serbët kanë udhëtuar në të gjitha pjesët e Kosovës. Ai ka filluar të qarkullojë në vitin 2001, pas një marrëveshje në mes të Qeverisë së Kosovës, Qeverisë së Serbisë dhe UNMIK-ut. Mirëpo, qarkullimi i trenit është ndërprerë më 3 mars 2008, kur *Hekurudhat e Serbisë* uzurpuan gjithë infrastrukturën e *Hekurudhave të Kosovës* në komunat e pjesës veriore. Treni akoma nuk ka filluar të qarkullojë. Për këtë arsye, shumicës së serbëve u është pamundësuar dalja nga enklavat e tyre, sepse për shkaqe sigurie ata nuk e shfrytëzojnë transportin publik, ose për shkak se transporti publik deri në enklavat serbe nuk është organizuar, apo sepse nuk kanë të holla për të paguar transportin privat me taksë.

Probleme të sigurisë kanë edhe shqiptarët që jetojnë në fshatrat në veri të Kosovës, në komunat Leposaviq/Leposavić, Zvečan/Zvečan, Zubin Potok/Zubin Potok dhe në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, ku serbët përbëjnë shumicën absolute. Shqiptarët e këtyre fshatrave nuk dalin individualisht pa përcjellje nga SHPK-ja, policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës gjendja nuk ka ndryshuar, sepse SHPK-ja, policia e UNMIK-ut apo KFOR-i vazhdon t'i shoqërojë autobusët të cilët transportojnë shqiptarët, nga këto fshatra deri në Mitrovicën/Mitrovica jugore ose Prishtinë/Priština.

Ka raste sporadike kur edhe boshnjakët që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës kanë probleme me lirinë e lëvizjes. Kjo në veçanti ka të bëjë me ata boshnjakë, të cilët më 17 nëntor 2007, shprehën dëshirën të votojnë në zgjedhjet parlamentare të Kosovës. Gjithashtu, boshnjakët e fshatit Revatskë/Rvatska janë vazhdimisht të kërcënuar nga serbët, sepse në fshat është duke u ndërtuar xhamia të cilën e kundërshtojnë serbët e këtushëm.

Të gjitha komunitetet pakicë, në përgjithësi kanë qasje të lirë në institucionet zyrtare, dhe kjo nuk ka ndryshuar pas 17 shkurtit të vitit 2008. Serbët gjithnjë e më pak i shfrytëzojnë shërbimet e zyrave për komunitete dhe shkojnë drejtpërdrejt në kuvendet komunale për t'i kryer punët e tyre administrative. Kjo veçanërisht vlen për serbët në qytetet e regjionit të Gjilanit/Gnjilane, Prizrenit/Prizren dhe Pejës/Peć, por deri diku edhe për ata të cilët jetojnë në qytetet

brenda regjionit të Prishtinës/Priština. Megjithatë, nëse në fshatrat e tyre gjenden zyrat për komunitete, serbët në radhë të parë do t'i shfrytëzojnë shërbimet e këtyre institucioneve. Për shembull, gjendje e tillë është me serbët e fshatit Bajë/Banja të komunës Skenderaj/Srbica. FDH – Kosovë vëren se pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në krahasim me periudhën paraprake, serbët që jetojnë jashtë enklavave shkojnë më rrallë në institucionet e Kosovës për t'i kryer punët e tyre administrative.

Serbët pothuajse të gjitha dokumentet nga komuna i marrin në gjuhën e tyre amtare. Përjashtim bën Kuvendi i komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje. Edhe pse gjuha turke është shpallur gjuhë zyrtare në Prizren/Prizren, akoma ka raste kur turqit i marrin dokumentet nga komuna në gjuhën shqipe. Në situatë të ngjashme janë boshnjakët në Mitrovicën/Mitrovica jugore, të cilët pothuajse të gjitha dokumentet nga kjo komunë i marrin në gjuhën shqipe. Kur është fjala për shqiptarët nga komunat në veri të Kosovës, ata pas shpalljes së pavarësisë më nuk shkojnë në komuna. Në komuna nuk shkojnë as zyrtarët shqiptarë që punojnë në zyrat për komunitete. Këto zyra më nuk janë në gjendje t'i kryejnë punët me të cilat janë ngarkuar, sepse vulat e tyre ndodhen në komunat serbe, prandaj janë të detyruar që të gjitha punët t'i kryejnë në Mitrovicën/Mitrovica jugore ose Prishtinë/Priština.

Komuniteti rom flet gjuhën shqipe ose serbe, prandaj edhe komunikimi me institucionet komunale bëhet në njërin nga këto gjuhë. Asnjë komunë nuk i lëshon dokumentet në gjuhën rome.

Nxënësit serbë dhe pjesa dërmuese e nxënësve romë dhe goranë, edhe më tej mësojnë sipas plan programeve të hartuara nga Qeveria e Serbisë. Ata vijojnë shkollat dhe fakultetet që janë në kompetencë të Qeverisë së Serbisë. Një pjesë e serbëve dhe romëve studiojnë në fakultetet e Serbisë. Nxënësit turq dhe boshnjak plotësisht janë të integruar në sistemin arsimor të Kosovës. Mësimet i ndjekin në gjuhën e tyre amtare, sipas plan programeve të Qeverisë së Kosovës.

Boshnjakët dhe turqit janë të kënaqur me numrin e shkollave fillore dhe të mesme, në të cilat fëmijët e tyre marrin mësim në gjuhën amtare, mirëpo nuk janë të kënaqur me numrin e institucioneve të larta arsimore në gjuhën boshnjake apo turke, në Kosovës. Turqit mund të vijojnë shkollimin e lartë në gjuhën e tyre

amtare në Fakultetin e Mësuesisë në Prizren/Prizren, i cili është degë e Universitetit të Prishtinës/Piština, si dhe në Seksionin për gjuhë turke dhe orientalistikë në Universitetin e Prishtinës. Për këtë arsye, ata shpesh shkojnë në Turqi për të ndjekur shkollimin universitar. Boshnjakët kanë mundësi të ndjekin shkollimin universitar në gjuhën e tyre amtare në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë dhe Fakultetin e Mësuesisë në Prizren/Prizren. Shumica e boshnjakëve i vazhdojnë studimet në universitetet e Bosnjës dhe Hercegovinës, kurse një numër i vogël i tyre edhe në fakultetet e Serbisë. Në Kosovë ekzistojnë universitete private ku boshnjakët dhe turqit mund të arsimohen në gjuhën e tyre amtare. Shkollimi në gjuhën rome nuk është organizuar as në shkollat kosovare dhe as në institucionet paralele arsimore të Qeverisë së Serbisë. Në shkollat fillore, të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Serbisë, romët mund të mësojnë gjuhën rome si lëndë fakultative. Një gjë e tillë nuk është organizuar në shkollat të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës.

Shërbimet shëndetësore që i ofrojnë spitalet dhe shtëpitë e shëndetit, në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, shfrytëzohen nga të gjitha bashkësitë tjera etnike, me përjashtim të serbëve të cilët mjekohen në qendrat shëndetësore paralele, të organizuara nga Qeveria e Serbisë. Në ambulancat serbe, përpos serbëve mjekohen edhe pjesëtarët e bashkësive tjera pakicë, si për shembull goranët dhe romët. Në vendimin për t'u mjekuar në ambulancat serbe ndikon edhe gjendja sociale, sepse në këto ambulanca nuk paguhet participimi, për dallim nga institucionet shëndetësore të udhëhequra nga shqiptarët. Megjithatë, FDH – Kosovë konstaton rritje të numrit të serbëve që kanë filluar t'i shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore të institucioneve të Kosovës. Gjendja nuk ka ndryshuar as pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Pjesëtarët e komuniteteve pakicë kanë vërejtje të mëdha në punën e përfaqësuesve të tyre në organet e nivelit lokal dhe qendror, si dhe në punën e zyrave për komunitete. Pakicat kërkojnë që drejtorët e zyrave për komunitete të zgjidhen me konkurs, dhe jo sipas përkatësisë partiake apo në bazë të marrëveshjeve mes partive.

Pjesëtarët e komuniteteve pakicë, në veçanti ata të cilët jetojnë në vendbanimet rurale të Kosovës, nuk janë të informuar për ekzistencën e ligjit mbi përdorimin e gjuhëve, ligjit kundër diskriminimit dhe ligjeve

tjera. Përfaqësuesit e komuniteteve pakicë insistojnë që të fillojë fushata për informimin e bashkëkombësve të tyre për ekzistencën e këtyre ligjeve dhe mënyrën e përdorimit të tyre, me qëllim që t'i mbrojnë të drejtat e veta.

Në përgjithësi, pakicat janë të kënaqura me shërbimet e ndërmarrjeve publike. Në shumicën e vendbanimeve rurale në Kosovë nuk ka rrjet të telefonisë fikse, që është domosdoshmëri për të gjithë qytetarët e Kosovës. Shumica e komuniteteve pakicë që jetojnë në fshatra nuk i marrin faturat e shërbimeve të ndërmarrjeve publike. Faturat kryesisht u dërgohen atyre që jetojnë në qytete. Faturat e KEK-ut dhe PTK-së janë edhe në gjuhën serbe. Megjithatë, turqit në Prizren/Prizren dhe Gjilan/Gnjilane, ku turqishtja është gjithashtu gjuhë zyrtare, faturat nga këto ndërmarrje publike nuk i marrin në gjuhën e tyre. Faturat e ndërmarrjeve tjera publike, siç janë kompania e ujësjellësit dhe higjienës së qytetit, janë akoma vetëm në gjuhën shqipe.

FDH – Kosovë ka vërejtur raste kur procesi i intervistimit të boshnjakëve dhe goranëve për vende të punës në KEK në Prizren/Prizren, është bërë në gjuhën shqipe, dhe kandidatët nuk i kanë kuptuar në tërësi pyetjet e parashtruara gjatë intervistës. Nga ana tjetër, ka edhe shembuj të mirë. Gjatë punësimit të boshnjakëve në Shtëpinë e shëndetit në Istog/Istok, gjithë procesi i intervistimit është kryer në gjuhën boshnjake.

RTK transmeton një herë në javë emisione informativo-argëtuese në gjuhën serbe, boshnjake, turke dhe rome, në kohëzgjatje prej një ore. Gjashtë herë në javë, prej të hënës deri të shtunën, në RTK transmetohen lajmet në kohëzgjatje prej 15 minutash në gjuhën turke, serbe dhe boshnjake. Nuk ka emisione informative në gjuhën rome.

RTK mbulon 78 për qind të territorit të Kosovës. Pjesa e mbetur, 22 për qind e territorit ku nuk ka sinjal të RTK-së, përfshin pjesë të regjionit të Prizrenit/Prizren ku jeton numri më i madh i boshnjakëve, turqve dhe goranëve dhe Mitrovicës/Mitrovica, ku serbët përbëjnë shumicën e popullsisë. Në këtë mënyrë pakicave u është mohuar e drejta në informim, gjë që e vështirëson integrimin e komuniteteve pakicë në shoqërinë kosovare.

Parapagimi për RTK është 3,5 euro dhe ajo është përfshirë në faturën e rrymës. Pakicat në regjionin e

Prizrenit/Prizren dhe Mitrovicës/Mitrovica ankohen se ata duhet të paguajnë taksën për RTK edhe pse nuk mund ta përcjellin programin këtij televizioni.

Krahas programit të RTK-së, serbët kryesisht informohen përmes RTS-së dhe stacioneve radio televizive në gjuhën serbe, të cilat gjenden kryesisht në pjesën veriore të Kosovës. Turqit në regjionin e Prizrenit/Prizren kanë gazetën *Yeni Donem* përmes së cilës marrin informata shtesë. Boshnjakët informohen edhe përmes Radio *Hayatt*. Disa radio stacione në Kosovë transmetojnë edhe program në gjuhën rome.

Vetëm një pjesë e vogël e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë informohet përmes internetit. Komunitetet pakicë, në përgjithësi, nuk janë të kënaqur me informatat në tabelat për shpallje në komuna, qytete dhe fshatra. FDH – Kosovë kë vërejtur se disa informata të publikuara në tabelat e shpalljeve janë të vjetra disa vite. E tillë është gjendja me tabelën e shpalljeve në Kuvendin e komunës së Dragashit/Dragaš, ku informacionet e shpallura datojnë nga viti 2002.

## Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

### 1.1. Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë

#### Të drejtat e njeriut

3.1 Të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

3.2 Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të parashtruara në:

- (a) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;
- (b) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj;
- (c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e Saj;

- (d) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;
- (g) Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare dhe
- (h) Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.

#### Të drejtat e komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre

4.4 Komunitetet dhe anëtarët e tyre kanë të drejtë:

- (a) Të përdorin lirisht gjuhën dhe alfabetin e tyre, duke përfshirë përdorimin e saj para gjykatave, organizmave dhe organeve të tjera publike të Kosovës;
- (b) Të arsimohen në gjuhën e tyre;
- (c) Të gëzojnë të drejtën për informacion në gjuhën e tyre;
- (d) Të gëzojnë të drejta të barabarta në lidhje me punësimin në organet publike të të gjitha niveleve dhe në shërbimet publike të të gjitha niveleve;
- (f) Të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit sipas ligjit;
- (g) Të krijojnë shoqata për të nxitur interesat e komunitetit;
- (h) Të kenë kontakte të papenguara dhe të marrin pjesë në organizatat lokale, rajonale dhe ndërkombëtare joqeveritare në përputhje me procedurat e këtyre organizatave;
- (i) Të ofrojnë informacion në gjuhën dhe alfabetin e komunitetit të tyre, duke përfshirë krijimin dhe mbajtjen e medieve të tyre;
- (j) Të ofrojnë arsim dhe të krijojnë institucione arsimore, në veçanti për shkollimin në gjuhën, alfabetin dhe kulturën e tyre si dhe në historinë e komunitetit të tyre për të cilën ofrojnë ndihmë financiare, duke përfshirë fondet publike në përputhje me ligjin e zbatueshëm, me kusht që plani programi të respektojë ligjin e zbatueshëm dhe të reflektojë frymën e tolerancës midis komuniteteve dhe respektin për të drejtat e njeriut dhe traditat kulturore të të gjitha komuniteteve;
- (k) Të nxisin respektin për traditat e komuniteteve;
- (l) Të ruajnë vendndodhjet me rëndësi fetare, historike ose kulturore për komunitetin në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse;
- (m) Të marrin dhe të sigurojnë shërbime shëndetësore publike dhe shërbime shoqërore, mbi baza jodiskriminuese, në përputhje me standardet e aplikueshme;
- (n) Të venë në funksionim institucionet fetare;

- (o) T'u garantohet qasje dhe përfaqësim në mediat elektronike publike, si dhe të kenë programe në gjuhët përkatëse dhe
- (p) Të financojnë veprimtaritë e tyre duke mbledhur kontribute vullnetare nga anëtarët e tyre ose nga organizata jashtë Kosovës, ose duke marrë financime të tilla të cilat mund të ofrohen nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes ose nga autoritetet publike lokale përderisa financimi i tillë të bëhet në një mënyrë plotësisht transparente.

### **Përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes**

5.2 Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes kanë gjithashtu përgjegjësi në fushën e administratës së mëposhtme lokale:

- (a) Të mbështesin bashkëpunimin ndër-komunal;
- (b) Të promovojnë zhvillimin profesional të shërbimit civil komunal;
- (c) T'i ndihmojnë komunat në përgatitjen e buxhetit të tyre dhe të sistemeve financiare të administrimit;
- (d) Të mbikëqyrin cilësinë e shërbimit komunal;
- (e) Të gjejnë mënyra dhe mjete për aktivitetet e trajnimit nëpër komuna;
- (f) T'u ndihmojnë komunave që t'i bëjnë aktivitetet e tyre transparente për publikun;
- (g) Të sigurojnë mbikëqyrje ligjore dhe këshilla për komunat;
- (h) T'i koordinojnë aktivitetet e agjencive ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare që u përkasin komunave dhe

## **1.2. Ligji për përdorimin e gjuhëve**

Dispozitat e përgjithshme

### Neni 1

1.1. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë:

- i. Përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike;
- ii. Status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, të drejta të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet e Kosovës;

iii. Të drejtën e të gjitha komuniteteve të Kosovës për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor;

iv. Karakterin shumë gjuhësor të shoqërisë kosovare, që paraqet vlerat e saj unike shpirtërore, intelektuale, historike dhe kulturore.

### Neni 2

2.1. Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.

2.2. Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës.

2.3. Në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën s, paku 5 përqind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do t, ketë statusin e gjuhës zyrtare në at, komunë dhe do përdoret barabartë me gjuhët zyrtare. Pavarësisht kësaj që u tha më lartë, në mënyrë të veçantë, në komunën e Prizrenit gjuha Turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare.

### Neni 3

3.1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pranuar, kërkuar dhe për të dhënë informata dhe ide në gjuhën e zgjedhur, pa ndërhyrje. Pranimi i lirë i transmetimit tej kufitar, qoftë i drejtpërdrejtë apo nëpërmjet të ritransmetimit apo riemërimit nuk ndalohet në baza të gjuhës. Ushtrimi i kësaj lirie mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tilla, që janë në pajtueshmëri me traktatet ndërkombëtare obliguese të të drejtave të njeriut.

3.2. Çdo person ka të drejtën për barazi para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Ndalohet çdo diskriminim në baza gjuhësore.

Përdorimi i gjuhëve në ndërmarrjet publike

### Neni 11

11.1. Në ndërmarrjet që janë në pronësi publike dhe në ndërmarrjet në pronësi shoqërore aplikohet barazia e gjuhëve zyrtare.

11.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet nga ndërmarrjet në pronësi publike dhe nga ndërmarrjet në pronësi shoqërore në cilëndo nga gjuhët zyrtare.

11.3. Çdo ndërmarrje e tillë ka për detyrë të sigurojë që çdo person të mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet në cilëndo gjuhë zyrtare.

Emrat personal

Neni 27

27.1. Emri dhe mbiemri i personit regjistrohet në regjistrat publikë, në dokumentet për identifikim personal dhe në dokumente të tjera zyrtare në sistemin me shkrim në gjuhët zyrtare të zgjedhur nga ai person.

27.2. Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, do të kenë të drejtën të regjistrojnë formën origjinale të emrit dhe mbiemrit të tyre në shkrimin dhe në pajtueshmëri me traditat dhe sistemin linguistik të gjuhës së tyre, si në regjistrat publikë, në dokumente për identifikim personal dhe në dokumente të tjera zyrtare, si dhe kjo formë do të përdoret nga zyrtarët publikë.

Neni 30

30.1. Në ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike aplikohet barazia e gjuhëve zyrtare në kryerjen e këtyre shërbimeve.

30.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet nga ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike në cilëndo gjuhë zyrtare. Çdo ndërmarrje e tillë ka për detyrë të sigurojë që çdo person të mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet në cilëndo gjuhë zyrtare.

30.3. Në komunat e banuara nga komunitetet, gjuha e të cilave gëzon statusin e gjuhës që flitet në komunë, vlejnë dispozitat e neneve 30.1 dhe 30.2.

### 1.3. Ligji kundër diskriminimit

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para Ligjit.

Neni 2

Parimet

Rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mos diskriminimin mbështetet në këto parime:

- a). Parimin e trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejt-përdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, races, pronës, lindjes ose statuseve tjera;
- b). Parimin e përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve lidhur me punësim në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet.
- c). Parimin e mirëkuptimit dhe tolerancës ndëretnike të qytetarëve të Kosovës.

Neni 4

Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat cenojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik, në fushat si vijon :

- a). kushteve për qasje në punësim, vetë punësim dhe të punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit dhe kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale dhe avancimet;
- b). qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvojën e punës praktike;
- c). kushtet e punësimit dhe kushtet e punës, përfshirë shkarkimin nga puna dhe pagesën;
- d). anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve ose të çdo organizate tjetër anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesione të caktuara, përfshirë edhe fitimet që mundësohen nga organizatat e tilla;

Kërkesat reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit

Pavarësisht nga nenet 2 a, 3a dhe 3 b, nuk konsiderohet diskriminim dallimi në trajtim i cili bazohet në dallimet e dhëna në bazat nën 2 a, mirëpo i cili si i tillë paraqet karakteristikën reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit, qoftë për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara profesionale, me kusht që qëllimi të jetë legjitim e kërkesat proporcionale me qëllimin.

## Regjioni i Prishtinës/Priştina

### 1. Serbët në Prishtinë/Priştina deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Aktualisht në Prishtinë/Priştina jetojnë rreth 100 pjesëtarë të komunitetit serb. Ata gëzojnë lirinë e lëvizjes në qytet, mirëpo akoma janë të kujdesshëm: lirisht shkojnë në shitoret e Prishtinës/Priştina, por pronarëve u drejtohen në gjuhën shqipe.

Serbët kanë qasje të lirë në institucionet komunale, mirëpo të gjitha punët e tyre administrative i kryejnë në zyrën për komunitete në Graçanicë/Gračanica. Gjithashtu, në Graçanicë/Gračanica ata blejnë gjithçka që u nevojitet. Zakonisht për qarkullim nuk e shfrytëzojnë transportin publik, por autobusët e UNMIK-ut. Përndryshe, akoma nuk është organizuar transporti publik në relacionin Prishtinë/Prishtina – Graçanicë/Gračanica.

Me zyrtarët e ndërmarrjeve publike serbët komunikojnë në gjuhën serbe. Mirëpo, kur u drejtohen këtyre kompanive me shkrim në gjuhën serbe, përgjigjen e marrin në gjuhën shqipe. Serbët pohojnë se nga të gjitha kompanitë publike, vetëm faturat e KEK-ut i marrin në gjuhën e tyre amtare.<sup>5</sup> Megjithatë, dokumentacioni tjetër i KEK-ut është në gjuhën shqipe

Serbët e Prishtinës/Priştina informohen nga programet e RTK-së në gjuhën serbe dhe RTS-së. Informata marrin edhe nga zyra për komunitete. Serbët nuk janë të interesuar të informohen për punën e komunës së Prishtinës/Priştina.

Ata konsiderojnë se kanë qenë të diskriminuar gjatë dhe pas procesit të privatizimit të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore.

*Kam punuar në hotelin Grand deri në qershor të vitit 1999. Pas kthimit të shqiptarëve nuk jam lajmëruar në punë nga frika. Kam dëgjuar në media serbe, por edhe prej një kolegu që jeton në Serbi, se hoteli është privatizuar. Kemi angazhuar një avokat që të kërkojë përqindje nga privatizimi i hotelit, për punëtorët të cilët kanë punuar aty. Neve na kanë thënë se nuk kemi të drejtë në përqindje, çka nuk është e vërtetë, prandaj kemi vendosur që këtë të drejtë ta realizojmë me rrugë gjyqësore.*

**M. K. serbe nga Prishtina/Priştina**  
Intervistë e FDH-së, 21 shkurt 2008

### 1.1 Serbët në Prishtinë/Priştina pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk kishte ndonjë ndikim të madh në pozitën e serbëve të cilët jetojnë dhe punojnë në Prishtinë/Priştina. Sidoqoftë, atmosfera e krijuar pas shpalljes së pavarësisë ka ndikuar që ata të ndihen më të pasigurt se më parë. Ata mendojnë se gjendja është e pasigurt dhe nuk e dinë si të veprojnë më tutje.

Sipas të dhënave të zyrtarëve të Kuvendit të komunës së Prishtinës/Priştina, para shpalljes së pavarësisë së Kosovës në institucionet komunale dhe kryesisht në Graçanicë/Gračanica, në zyrën për komunitete dhe zyrën për kthim kanë punuar 65 serbë. Një numër më i vogël i serbëve punonte në godinën e Kuvendit komunal në Prishtinë/Priştina. Pas një pauze dyjavore, pas 17 shkurtit të vitit 2008, të gjithë serbët janë kthyer në vendet e tyre të punës, madje edhe ata që kanë punuar në Prishtinë/Priştina.

<sup>5</sup> Bashkëbiseduesi i FDH-Kosovë nuk ka telefon fiks, prandaj nuk e dinë se në cilat gjuhë përgatiten faturat e PTK-së.

Serbët që punojnë në Prishtinë/Priština i shfrytëzojnë autobusët e UNMIK-ut për të ardhur në vendet e tyre të punës. Edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk është vendosur transporti publik deri në Graçanicë/Gračanica.

Zyra për kthim e Kuvendit komunal të Prishtinës/Priština vazhdon të funksionojë. Të punësuarit në këtë zyrë i vizitojnë si serbët që jetojnë në Prishtinë/Priština, ashtu edhe ata që jetojnë në fshatrat përreth. Zyrtarët e zyrës për kthim përcjellin realizimin e projekteve të ndryshme, të cilat i ka ndërmarrë komuna e Prishtinës/Priština, me qëllim të krijimit të kushteve për kthim të qëndrueshëm. Megjithatë, zyra për kthim nuk funksionon me kapacitet të plotë, sepse pas 17 shkurtit grupi punues për kthim, të cilin përpos zyrtarëve komunal e përbënin edhe përfaqësuesit e shoqatave të ndryshme serbe të personave të zhvendosur dhe të kthyer, përfaqësuesit e UNMIK-ut dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare, të cilat kanë ofruar ndihmë financiare për kthimin e personave të zhvendosur në Kosovë, nuk është mbledhur asnjëherë. Deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, mbledhjet e grupit punues janë mbajtur rregullisht.

*Unë jam zyrtare në zyrën për kthim në KK të Prishtinës, ku punoj prej fillimit të vitit 2006. Unë me familje jetoj në Graçanicë. Çdo ditë udhëtoj nga Graçanica në Prishtinë për të shkuar në punë. Vij në punë sepse askush nuk më pyet nëse kam me çka ta mbaj familjen time. Për të ardhur këtu i shfrytëzoj autobusët e UNMIK-ut. Ka edhe serbë të tjerë që vijnë në punë në Prishtinë me autobusë të UNMIK-ut. Asnjëherë gjatë udhëtimit nuk kam pasur problem. Përndryshe, gjendja për ne serbët tash është bërë më e pasigurt. Nuk e dimë si do të veprojmë në të ardhmen.*

**S. S. zyrtare në zyrën për kthim në KK të Prishtinës/Priština**  
Intervistë e FDH-së, 26 mara 2008

*Në komunën e Prishtinës punojnë gjithsej 65 serbë. Pjesa më e madhe e tyre është e punësuar në Graçanicë, në zyrën për komunitete dhe zyrën për kthim. Të gjithë serbët e punësuar në Kuvendin komunal, duke përfshirë edhe ata që punojnë këtu në Prishtinë, vijnë në punë rregullisht. Disa prej tyre morën pushim gjatë javës së parë dhe të dytë pas shpalljes së pavarësisë, por tani të gjithë janë kthyer në punë.*

**H. H. drejtor i administratës të përgjithshme në KK të Prishtinës/Priština**  
Intervistë e FDH-së, 26 mars 2008

*Pa marrë parasysh situatën e krijuar, ne i vizitojmë rregullisht të gjithë serbët që jetojnë këtu në Prishtinë, por edhe ata në vendbanimet rurale. Familjet që jetojnë në Prishtinë, kryesisht përbëhen nga njerëz të moshuar dhe kanë nevojë për mbështetje. Nga përvoja ime gjatë punës në zyrën për kthim, mund të them se shumica e personave të shpërngulur, të cilët kanë vendosur të kthehen, janë shumë të interesuar të gjejnë ndonjë punë dhe me kënaqësi do të praninin të punojnë për institucionet kosovare. Ata na thonë: „çka më duhet shtëpia nëse nuk kam punë prej të cilës do të jetoja“*

**M. N. zyrtar i zyrës për kthim në KK të Prishtinës/Priština**  
Intervistë e FDH-së, 1 prill 2008

## **1.2 Serbët në Shërbimin Policor të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

Në SHPK para shpalljes së pavarësisë kanë punuar gjithsej 7119 policë. 6011 ose 84.44 për qind shqiptarë, 710 ose 9.97 për qind serbë, 215 ose 3.02 për qind boshnjakë, 86 ose 1.21 për qind turq, 38 ose 0.53 për qind goranë, 22 ose 0.31 për qind romë, 21 ose 0.29 për qind ashkali, shtatë ose 0.10 për qind egjiptianë, pesë ose 0.07 për qind çerkezë, tre ose 0.04 për qind kroatë dhe një maqedonas. Pas 17 shkurtit, 296 policë serb kanë refuzuar të paraqiten në punë, me arsyetimin se nuk duan të punojnë nën komandën e SHPK-së dhe kanë kërkuar të jenë nën komandën e UNMIK-ut. Në ndërkohë, katër prej tyre janë kthyer në punë. 292 policët tjerë serbë kanë vazhduar bojkotin. Tani ata janë të suspenduar. Policët serbë të suspenduar kanë punuar në regjionet e Prishtinës/Priština, Gjilanit/Gnjilane, Pejës/Peć dhe në policinë kufitare. Për momentin në SHPK punojnë gjithsej 418 policë serbë.

Për sa u përket komunave në veri të Kosovës, Mitrovicë/Mitrovica veriore, Zveçan/Zvečan, Leposaviq/Leposavić dhe Zubin Potok/Zubin Potok, policët serbët nuk e kanë lëshuar punën sepse janë akoma nën komandën e policisë së UNMIK-ut. Procesi i bartjes së kompetencave nga policia e UNMIK-ut te SHPK-ja në komunat veriore të Kosovës ka filluar para shpalljes së pavarësisë. Në këtë moment procesi i bartjes së kompetencave akoma nuk ka përfunduar dhe nuk dihet si do të reagojnë policët serbë të pjesës veriore të Kosovës kur SHPK-ja ta marrë komandën mbi ata.

Ashtu si edhe para shpalljes së pavarësisë edhe pas 17 shkurtit, SHPK-ja përpiket që patrullat e saj të pasqyrojnë strukturën etnike të vendbanimit ku ato patrullojnë. Në vende ku serbët e kanë braktisur SHPK-në, për sigurinë kujdeset policia e UNMIK-ut, pjesëtarët shqiptarë të SHPK-së dhe KFOR-i. Për shembull, një situatë e tillë është në Graçanicë/Gračanica. Për të siguruar qëndrimin e serbëve në SHPK pas shpalljes së pavarësisë, SHPK-ja ka ofruar masa shtesë të sigurisë nëse ndonjë nga policët ndihet i frikësuar. Megjithatë, serbët refuzuan.

*Ata (292 pjesëtarët serbë të SHPK-së) nuk janë paraqitur në punë për një kohë të caktuar. Në rrethana të tilla inspektorati policor duhet të sjellë vendime në përputhje me rregulloren. Ata janë suspenduar por vazhdojnë të marrin rrogën e plotë, deri në marrjen e një vendimi tjetër nga inspektorati. Pjesëtarët e suspenduar të SHPK-së punonin në regjionet e Prishtinës, Gjilanit, Pejës dhe policisë kufitare. Aktualisht 418 pjesëtarë serbë të SHPK-së vazhdojnë të vijnë rregullisht në punë.*

**V. E. zëdhënës i SHPK-së**  
Intervistë e FDH-së, 26 mars 2008

### **1.3 Serbët në Hekurudhat e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

Para 17 shkurtit, në *Hekurudhat e Kosovës* punonin gjithsej 41 serbë. Më 3 mars të vitit 2008, *Hekurudhat e Serbisë* e kanë uzurpuar në tërësi infrastrukturën e *Hekurudhave të Kosovës* në komunat e pjesës veriore të Kosovës. Prej atëherë, 19 punëtorët e nacionalitetit serbë nga Mitrovica/Mitrovica e veriut, Zveçani/Zvečan, Zubin Potoku/Zubin Potok dhe Leposaviqi/Leposavić, kanë deklaruar se ata nuk duan të punojnë për *Hekurudhat e Kosovës* dhe vihen në dispozicion të *Hekurudhave të Serbisë*. Në përputhje me rregulloren, *Hekurudhat e Kosovës* i kanë suspenduar 19 punëtorët e lartpërmendur dhe deri në vendimin e ardhshëm të udhëheqjes atyre do t'u paguhet 50 për qind e pagës. Punëtorët tjerë serbë vazhdojnë të punojnë në këtë ndërmarrje publike.

Uzurpimi i hekurudhës pati për pasojë ndërprerjen e »Trenit të lëvizjes së lirë«, i cili qarkullonte në relacionin prej Fushë Kosovës/Kosovo Polje deri në Leshak/Leška në komunën e Leposaviqit/Leposavić dhe prej Fushë Kosovës/Kosovo Polje deri në Hanin e Elezit /Đeneral Janković, e që kryesisht është shfrytëzuar nga serbët. Këtë tren e kanë përdorur edhe pjesëtarët

e bashkësive tjera etnike, por në radhë të parë e kanë shfrytëzuar serbët për shkaqe sigurie. Projekti »Treni i lëvizjes së lirë« është iniciuar në vitin 2001, pas arritjes së marrëveshjes të cilën e kanë nënshkruar zyra për komunitete e UNMIK-ut, Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Serbisë, në mënyrë që të mundësohet qarkullimi i lirë i serbëve dhe mallrave të tyre nëpër pjesët e ndryshme të Kosovës dhe në Serbi. Këtë projekt e ka subvencionuar Qeveria e Kosovës, kurse e kanë realizuar *Hekurudhat e Kosovës*. »Treni i lëvizjes së lirë« nuk ka filluar akoma të qarkullojë, me çka shumicës serbe vazhdon t'i pamundësohet udhëtimi jashtë enklavave, pjesërisht për shkak të faktit se për arsye sigurie ata nuk e shfrytëzojnë qarkullimin publik, kurse pjesërisht edhe për shkak se nuk është organizuar qarkullimi publik deri në enklavat serbe ose ngaqë nuk kanë të holla ta paguajnë transportin me taksë.

*Unë mendoj se ata do të kthehen në punë kur situata të përmirësohet. Këta punëtorë do ta marrin 50 për qindëshin tjetër të rrogës. Punëtorët tjerë serbë akoma punojnë në hekurudha pa kurrfarë problemesh. Përndryshe, të gjithë 19 punëtorët që e lëshuan punën, punonin në Mitrovicën e veriut si dhe në stacionet në relacionin Fushë Kosovë – Leshak - Fushë Kosovë. Të gjithë ata janë deklaruar se duan të punojnë për hekurudhat e Serbisë.*

**R. M. udhëheqës i burimeve njerëzore të Hekurudhave të Kosovës**

Intervistë e FDH-së, 1 prill 2008

### **1.4 Serbët në Shërbimin Korrektues të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë të Kosovës**

Para shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt, Ministria e drejtësisë, Nekibe Kelmendi, është përpjekur t'i bindë 154 punëtorët serbë të cilët punonin në këtë institucion të qëndrojnë në punë, në shërbimin korrektues të Kosovës. Me atë rast, serbët në parim janë pajtuar të qëndrojnë në punë. Megjithatë, pas presionit të ushtruar nga ana e Qeverisë së Serbisë, ata e kanë lëshuar shërbimin. Edhe pas lëshimit të punës, Ministria e drejtësisë ka provuar disa herë t'i kthejë ata në punë, por nuk kishte sukses. Pas kësaj, më 14 mars 2008, shërbimi korrektues i Kosovës në zbatim të dispozitave të rregullores së vet i ka suspenduar 82 punëtorët serbë që nuk janë lajmëruar në punë. Ata tani marrin 70 për qind të rrogës. Ky vendim do të jetë në fuqi

për 60 ditë. Njëri nga 82 punëtorët e suspenduar punonte në drejtorinë qendrore të shërbimit korrek-tues të Kosovës, 27 të tjerë në qendrën korrektuese në Lipjan/Lipljan, 37 në burgun e Lipjanit/Lipljan dhe 17 në burgun e Gjilanit/Gnjilane. 72 pjesëtarët tjerë të komunitetit serbë kanë vazhduar të punojnë për këtë institucion kosovar.

Sipas të dhënave të datës 8 mars 2008, Shërbimi Korrektues i Kosovës kishte gjithsej 1550 të punësuar, prej të cilëve 213 ose 13.74 për qind ishin pjesëtarë të pakicave kombëtare. Prej këtyre 213 punëtorëve nga radhët e komuniteteve pakicë 154 ishin serbë, 37 boshnjakë, pesë turq, 15 romë, ashkali dhe egjiptas, një slloven dhe një malazez.

*Edhe pas suspendimit, Ministria është përpjekur të vendosë kontakt me punëtorët serbë, duke i ftuar ata publikisht të kthehen në punë dhe t'i kundërvihen presionit të Qeverisë së Serbisë. Punëtorët serbë kanë deklaruar se qeveria serbe ua ka ndaluar të kthehen në institucionet kosovare. Ata kanë theksuar se pikërisht ardhja e Ministrit për Kosovë dhe Metohi, Samarxhiq, i ka zvogëluar gjasat që të kthehen në punë ... edhe përkundër faktit se disa nga punëtorët e suspenduar treguan vullnet të takohen me Ministren e drejtësisë dhe të kthehen në punë, në momentin e fundit janë detyruar të heqin dorë nga kjo, për shkak të kërcënimeve. Dy prej tyre u rrahën nga bashkëkom-bësit e vet disa ditë më parë.*

**R. H. komesar i Shërbimit Korrektues të Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 4 prill 2008

### **1.5 Serbët në doganat e UNMIK-ut pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

*Dogana e UNMIK-ut aktualisht punëson 562 punëtorë: 467 janë shqiptarë, 58 serbë, 17 boshnjakë, 14 turq, tre goranë, dy janë romë dhe një ashkali. Për shkak të dys-himit se kanë shkelur rregulloren e punës pas 17 shkurtit 2008, janë suspenduar 49 punëtorë serbë dhe tre bosh-njakë. Deri tani, asnjë nga të suspenduarit nuk është kthyer në punë. Nëntë serbë nuk e kanë lëshuar punën dhe vazhdojnë t'i kryejnë detyrat e tyre në doganë.*

**B. K. zyrtar i sektorit për burime njerëzore në doganë**  
Intervistë e FDH-së, 15 prill 2008

Sipas vendimit, të gjithë të suspenduarit kanë marrë rrogën e plotë për muajin shkurt. Megjithatë, pas një marsit, asnjërit nga të suspenduarit nuk do t'i paguhet mëditja për ditët që nuk kanë ardhur në punë.

### **1.6. Serbët në KEK pas shpalljes së pavarësisë të Kosovës**

Në KEK janë të punësuar gjithsej 7.452 punëtorë. Në bazë të të dhënave statistikore, të cilat FDH – Kosovë i ka marrë nga sektori i burimeve njerëzore në KEK, numri i përgjithshëm i të punësuarve nga radhët e komuniteteve pakicë në këtë ndërmarrje publike është 105 ose 2.27 për qind, nga të cilët 29 janë boshnjakë, 28 serbë, 27 turq, tre romë dhe 18 të tjerë. Shërbimi i burimeve njerëzore në KEK, nuk ka marrë informata nga qendrat e veta regionale se dikush nga pjesëtarët e punësuar të pakicave kombëtare e ka lëshuar vendin e tij të punës, ose nuk ka ardhur në punë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.<sup>6</sup>

### **1.7 Serbët në PTK pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

Në PTK janë të punësuar gjithsej 2.484 punëtorë. Prej tyre, 117 ose 4.71 për qind vijnë nga radhët e komu-niteteve pakicë. Numrin më të madh të punëtorëve joshqiptarë e përbëjnë serbët (gjithsej 41). Ata punojnë nëpër enklavat serbe në komunat Prishtinë/Priština (22), Prizren/Prizren (4), Mitrovicë/Mitrovica (11), Pejë/Peć (2) dhe Gjilan/Gnjilane (2). Gjithsej janë të punësuar 32 pjesëtarë të komunitetit turk dhe atë në komunat Prishtinë/Priština (13), Prizren/Prizren (18), dhe në Gjilan/Gnjilane (1). Gjithsej janë të punësuar 30 punë-torë nga grupi i myslimanëve<sup>7</sup>. Ata punojnë në komunat: Prishtinë/Priština (2), Prizren/Prizren (16), Mitrovicë/ Mitrovica (3) dhe Pejë/Peć (9). Në PTK janë të punësuar 14 ashkalinjë, romë, egjiptas dhe çerkez, ndërsa puno-jnë në komunat e Prizrenit/Prizren (11), Mitrovicës/ Mitrovica (2) dhe Gjilanit/Gnjilana (1). Shërbimi i buri-meve njerëzore të PTK-së, nuk ka të dhëna nëse ndonjë nga të punësuarit nga radhët e bashkësive pakicë e ka lëshuar vendin e punës, apo nuk është lajmëruar në punë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.<sup>8</sup>

6 A.K. zyrtar i sektorit të burimeve njerëzore në KEK, Intervistë e FDH-së, 1 prill 2008

7 Pjesëtarët e kësaj bashkësie janë kryesisht boshnjakët dhe goranët etnikë.

## 1.8 Serbët në Aeroportin e Prishtinës/ Priština pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Në aeroport ka gjithsej 576 punëtorë, prej tyre 13 janë pjesëtarë të pakicave kombëtare: pesë serbë, dy boshnjakë, një pjesëtarë i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, katër turq dhe një sirian. Asnjë prej të punësuarve nga radhët e pakicave nuk e ka lëshuar vendin e punës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.<sup>9</sup>

## 2. Serbët në Fushë Kosovë/Kosovo Polje deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje jetojnë rreth 4.000 serbë. Serbët në këtë komunë, në përgjithësi kanë liri të lëvizjes. Ata blejnë në shitoret që janë në pronësi të shqiptarëve dhe, me këtë rast, shërbehen në gjuhën e tyre amtare. Megjithatë, serbët janë të vëmendshëm sepse jo rrallëherë të rinjtë shqiptarë i thërrasin me emra ofendues dhe i provokojnë. Për këtë arsye, te serbët e këtushëm akoma është e pranishme frika.

Serbët kanë qasje në të gjitha institucionet komunale. Por, marrë në përgjithësi në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje ligji mbi përdorimin e gjuhëve nuk respektohet. Pothuajse të gjitha informatat në tabelat për shpallje janë vetëm në gjuhën shqipe. Serbët theksojnë se nuk kanë probleme me zyrtarët e vjetër, sepse ata flasin serbisht, por kanë vështirësi komunikimi me zyrtarët e rinj.

*Në komunikim verbal me zyrtarët e vjetër nuk kam problem, sepse ata e flasin gjuhën serbe. Personat e rinj nuk duan të na ndihmojnë, ose edhe nëse na ndihmojnë duhet të presim gjatë për përgjigje. Kemi dy mundësi: ose të jemi këmbëngulës ose të heqim dorë nga shërbimet e organeve komunale.*

**S. S. Serbe nga Fushë Kosova/ Kosovo Polje**  
Intervistë e FDH-së, 21 shkurt 2008

Në qendrën për punë sociale në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, ligji mbi përdorimin e gjuhëve pothuajse fare nuk respektohet. Serbët e punësuar këtu, nuk e kanë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për punë

dhe ballafaqohen me probleme gjatë përmbushjes së detyrave të përditshme. Gjatë mbledhjeve të kolegji-umit nuk është siguruar përkthimi, prandaj kolegët shqiptarë përkthejnë për kolegët e tyre serbë. Të gjitha informatat në lidhje me kategoritë e popullsisë të cilat mund të marrin ndihmë sociale janë vetëm në gjuhën shqipe.

*Qendra për punë sociale i ka formularët e përgatitur në dy gjuhë. Vendimi, nëse kërkesa e palës është pranuar apo refuzuar, është i shkruar vetëm në gjuhën shqipe, kështu që nuk e dimë nëse dikush e ka marrë statusin e rastit social apo jo.*

**S. S. serbe nga Fushë Kosova/Kosovo Polje**  
Intervistë e FDH-së, 21 shkurt 2008

*Unë punoj në qendrën për punë sociale. Kam disa vërejtje kur bëhet fjalë për ligjin mbi përdorimin e gjuhëve. Mbledhjet mbahen në gjuhën shqipe kurse dikush prej kolegëve i përkthen ato për mua. Komunikimi me kolegët më të vjetër është e mirë, sepse ata flasin serbisht kurse unë e kam mësuar pak shqipen. Sa i përket dokumentacionit, në gjuhën serbe e kam marrë vetëm ligjin mbi skemën e ndihmës sociale në Kosovë dhe atë të vitit 2005. Nuk kam marrë asnjë rregullore tjetër në gjuhën serbe. Disa herë i jam ankuar eprorit, por gjithmonë marr përgjigjen se dokumentet në gjuhën serbe do t'i marr herën tjetër, ose thjesht nuk ka dokumente në këtë gjuhë. Të gjitha dokumentet që më jepen janë në gjuhën shqipe, kolegët i përkthejnë ato gojarisht për mua dhe unë i nënshkruaj, mirëpo gjithmonë shënoj vërejtje se dokumenti më është përkthyer nga laikët në gjuhën serbe, sepse unë vetë nuk e di çka po nënshkruaj. Formularët janë në gjuhën shqipe dhe serbe, por përgjigjet, me arsyetimin për pranimin apo refuzimin e palës që ka aplikuar për ndihmë sociale, shkruhet gjithmonë vetëm në gjuhën shqipe.*

**J. M. serbe nga Fushë Kosova/Kosovo Polje**  
Intervistë e FDH-së, 21 shkurt 2008

Nxënësit serbë nga komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje ndjekin mësimin në shkollat të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Serbisë. Të gjithë serbët mjekohen ekskluzivisht në ambulancat serbe.

Serbët i marrin faturat e ndërmarrjeve publike, siç është KEK-ut, Ujësjetllësi Regjional Priština dhe

8 B.J. drejtor i burimeve njerëzore në PTK, Intervistë e FDH-së, 25 prill 2008

9 A.A. zyrtar i sektorit për burime njerëzore në Aeroportin e Prishtinës/Priština, FDH- Intervistë 18 prill 2008

Higjiena si dhe nga disa banka, si p.sh *Kasa Banka*, në gjuhën e tyre amtare, mirëpo asnjë ndërmarrje publike në fatura nuk i shkruan drejt emrat e tyre. Emrat e serbëve shkruhen sipas rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe.

Serbët kryesisht informohen përmes RTS-së dhe programeve të RTK-së në gjuhën serbe. Ata ankohen se duhet të paguajnë parapagimin njëjtë sikur shqiptarët, edhe pse kanë vetëm një emision informativ-argëtues në gjuhën serbe „*Nedeljni kolaž*“, i cili transmetohet të dielën në ora 12.30 dhe lajmet që transmetohen çdo ditë, nga e hëna deri të shtunën, prej orës 19.00 deri 19.15. Serbët nuk kanë asnjë informatë për vendet e punës dhe aktivitetet e komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje.

## 2.1 Serbët në Fushë Kosovë/Kosovo Polje pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, pozita e komunitetit serb në Fushë Kosovë/Kosovo Polje nuk ndryshoi dukshëm. Ata pohojnë se nëpër rrugë ka një numër më të vogël të serbëve, gjë që ndikon negativisht në krijimin e ndjenjës së pasigurisë.

Aktualisht, një prej problemeve më serioze për gjithë serbët e komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje është fakti se »Treni i lëvizjes së lirë« nuk qarkullon më. Ata e kanë shfrytëzuar trenin për të udhëtuar nëpër enklavat tjera serbe në Kosovën qendrore dhe veriore, si dhe në Serbi, ku shkonin për të blerë, studiuar ose për të shitur prodhimet e tyre bujqësore. Për të shkuar në Graçanicë, Mitrovicë/Mitrovica veriore apo në Serbi, tash atyre u duhet të qarkullojnë me taksi, të cilët janë të shtrenjtë dhe të pasigurt, për shkak se taksistët janë serbë dhe veturat e tyre kanë regjistrime serbe. Disa serbë në pjesët tjera të Kosovës udhëtojnë me vetura private. Ata që i kanë tabelat serbe ndihen të pasigurt kur kalojnë nëpër vendbanimet me shumicë shqiptare, përderisa ata që vozisin automjete me tabela të Kosovës ndihen shumë më të sigurt.

Kuvendi i komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje kishte të punësuar 34 pjesëtarë të komunitetit serb. Para 17 shkurtit, në administratën komunale kishte 19 serbë të punësuar, kurse 15 serbë ishin të punësuar në sektorin e shëndetësisë në Shtëpinë e shëndetit në Fushë Kosovë/Kosovo Polje e cila është nën autoritetin e Qeverisë së Kosovës. Pas shpalljes së pavarësisë,

serbët nuk janë lajmëruar në punë për dy javë. Një pjesë e serbëve mori pushim deri në fund të marsit. Vetëm dy nga 19 serbët e punësuar në administratë, u kthyen në punë javën e tretë pas pavarësisë. Sa u përket serbëve të punësuar në sektorin e shëndetësisë, vetëm pesë nga 15 të punësuarit vijnë në punë, por edhe ata qëndrojnë në vendet e punës shumë shkurt.

*Në komunën tonë nuk kishte incidente ndëretnike pas shpalljes së pavarësisë, por unë vazhdoj të jem e vëmendshme sepse nuk i shoh kolegët serbë në komunë, të cilët pas pavarësisë nuk po lajmërohen në vendet e tyre të punës. Gjithashtu, rrallë shoh serbë nëpër rrugët e qytetit, prandaj kjo më bën të ndihem e pasigurt. Ndjenja e pakëndshme shtohet kur kolegët shqiptarë shprehin befasinë që jam kthyer në punë.*

**J. M. zyrtare në qendrën për punë sociale në Fushë Kosovë/Kosovo Polje**  
Intervistë e FDH-së, 8 prill 2008

*Punëtori T. D. i punësuar në zyrën për komunitete është akoma në pushim vjetor, deri në fund të marsit të vitit 2008. B. R. shëf i zyrës për shëndetësi, gjithashtu ndodhet në pushim vjetor. S. G. vjen në punë çdo ditë, por qëndron vetëm dhjetë minuta. Kur bëhet fjalë për shërbimin shëndetësor ku punojnë 15 serbë, vetëm pesë prej tyre kanë filluar të vijnë në punë tre javë pas shpalljes së pavarësisë, por edhe ata nuk janë të rregullt, do të thotë lajmërohen në punë për një kohë të shkurtër. Në bazë të këtyre të dhënave shihet se vetëm dy punëtorë të komunitetit serb vijnë në punë dhe atë nga java e tretë pas shpalljes së pavarësisë të Kosovës. Punëtorët e tjerë nuk janë deklaruar nëse do të punojnë ose jo dhe kjo status quo do të vazhdojë deri në fund të marsit të vitit 2008, kur udhëheqja e komunës do të ndërmarrë masat e nevojshme, të cilat nuk do të dallojnë nga vendimet e komunave tjera dhe nuk do të jenë në kundërshtim me vendimin e Kryeministrit të Kosovës.*

**M. M. menaxher i personelit të KK të Fushë Kosovës/ Kosovo Polje**  
Intervistë e FDH-së, 2 prill 2008

## 3. Romët në Fushë Kosovë/Kosovo Polje deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje para lufte kanë jetuar mes 4.000 e 5.000 romë. Sot kanë mbetur rreth 600. Romët po shpërngulen vazhdimisht, për

shkak se janë raste sociale dhe nuk kanë kushte themelore për jetesë.

Në vendbanimet ku jetojnë romët, qoftë në fshatra apo qytete, kushtet për jetesë janë të këqija. Vendbanimet e tyre janë në afërsi të hedhurinave, gjë që ndikon në shëndetin e tyre. Romët ankohen se ndaj tyre bëhet segregacion i vazhdueshëm. Shembull për këtë është fshati Kuzmin/Kuzmin ku romët jetojnë së bashku në një qytet me serbët.

*Këto hedhurina janë krijuar nga pakujdesia e qytetarëve, të cilët e kanë më të lehtë t'i hedhin mbeturinat aty ku jetojnë romët sepse ata nuk ankohen. Shembull i segregacionit është fshati Kuzmin. Vendbanimet janë të ndara. Në pjesën ku jetojnë serbët infrastruktura është në nivel, kurse në vendin ku jetojnë romët pothuajse nuk ka infrastrukturë. Në lagjen e romëve gjendet deponia e hedhurinave, të cilën e kanë krijuar banorët e këtij fshati dhe fshatrave përreth.*

#### **M. B. rom nga Fushë Kosova/Kosova Polja**

Intervistë e FDH-së, 21 shkurt 2008

Të gjithë romët e komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje gëzojnë lirinë e plotë të lëvizjes.

Gjuha rome nuk është në përdorim zyrtar, prandaj kur i drejtohen komunës ata flasin në gjuhën shqipe ose serbe. Romët thonë se ata të cilët u drejtohen zyrtarëve shqiptarë të komunës në gjuhën shqipe, punën e kryejnë më shpejt.

Rreth 90 për qind e romëve të kësaj komune e ndjekin mësimin në shkollat serbe, në gjuhën serbe. Pjesa tjetër e romëve vijojnë shkollat që janë në kompetencë të Ministrisë të Kosovës për arsim, shkencë dhe teknologji (MASHT). Në shkollat serbe, romët kanë mundësi të mësojnë gjuhën rome si lëndë zgjedhore, derisa një aktivitet i tillë nuk është organizuar në shkollat që janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës.

Romët nuk janë të kënaqur me nivelin e informimit në gjuhën e tyre amtare. Në radhë të parë atyre u pengon që programi i RTK-së në gjuhën rome është më i shkurtër se programet e ngjashme në gjuhët e komuniteteve tjera pakicë, të cilat zgjasin një orë. Programi në gjuhën rome zgjat 45 minuta. Përpos kësaj, nuk transmetohen emisione informative në gjuhën rome, ndërsa përgatiten emisione informative në gjuhët e komuniteteve tjera. Prandaj, romët ankohen që duhet

të paguajnë të njëjtën shumë sikur pjesëtarët e komuniteteve tjera.

*Ekzistojnë katër radiostacione lokale që transmetojnë programe ditore në gjuhën rome, në kohëzgjatje prej një ore. Gjatë këtyre emisioneve nuk jepen informata për mbledhjet, tribunat dhe diskutimet që i organizon komuna, e as për konkurset për vende të punës. Këtë boshllëk mundohem ta plotësojë unë si përfaqësues i romëve në komunë, duke dërguar pllakate në gjuhën shqipe dhe serbe, ose në të dy gjuhët, në çdo fshat apo lagje, përmes liderëve të romëve. Nuk shkruaj në gjuhën rome sepse nuk është bërë standardizimi i gjuhës tonë.*

#### **M.B. rom nga Fushë Kosova/Kosovo Polje**

Intervistë e FDH-së, 21 shkurt 2008

Aktualisht janë të punësuar vetëm dy pjesëtarë të komunitetit rom: njëri punon në komunë, kurse tjetri në ambulancën serbë në fshatin Uglar/Ugljare.

*Rreth 60 familje rome janë raste sociale, derisa të tjerët ekzistencën e sigurojnë duke kërkuar nëpër kontejnerët dhe deponitë e mbeturinave. Shpesh më ka rënë të dëgjoj se romët nuk janë të përfaqësuar nëpër institucione dhe ndërmarrje publike, sepse nuk janë të kualifikuar. Nuk është e vërtetë se romët janë të pakualifikuar, ka mjaft romë që kanë përfunduar shkollën e mesme. Në këtë drejtim na ka ndihmuar shumë projekti i shkollimit të shpejtuar, i cili u ka mundësuar shume nxënësve, që e kishin lënë shkollën për shkaqe ekonomike, të kthehen në bankat shkollore. Gjatë dy muajve të fundit, katër familje me 25 anëtarë e kanë lëshuar Kosovën nga pamundësia për t'u punësuar. Dy familje e kanë shitur pronën e tyre, kështu që ky trend nuk do të ndalet nëse komuniteti rom vazhdon të injorohet në këtë drejtim.*

#### **M.B. rom nga Fushë Kosova/Kosovo Polje**

Intervistë e FDH-së, 21 shkurt 2008

## **4. Serbët dhe romët në Plemetin/**

### **Plemetine deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës**

Fshati Plemetin/Plemetine gjendet në komunën e Obiliqit/Obilić. Në fshat jetojnë rreth 1000 serbë dhe rreth 300 deri 400 romë. Serbët dhe romët e fshatit vazhdimisht po shpërngulen për shkak të mungesës së perspektivës.

Serbët dhe romët e Plemetinit/Plemetine mendojnë se akoma nuk kanë liri të lëvizjes. Banorët jetojnë me frikë nga sulmet e mundshme. Për shkak të frikës ata nuk i punojnë arat e tyre që ndodhen larg fshatit, e as nuk shkojnë në ato kafene të Obiliqit/Obilić të cilat frekuentohen edhe nga shqiptarët. Kohë pas kohe, kalimtarët shqiptarë i ofendojnë serbët me fjalë fyese. Transporti publik nuk qarkullon në relacionin Plemetin/Plemetine – Obiliq/Obilić dhe anasjelltas. Si mjet transporti, serbët dhe romët e këtushëm e shfrytëzojnë trenin, i cili qarkullon në relacionin Mitrovicës/Mitrovica-Prishtinë/Priština dhe që kalon nëpër fshat katër herë në ditë. Gjithashtu ata shfrytëzojnë edhe shërbimet e taksive, vozitësit e të cilëve janë serbë.

Serbët dhe romët kanë qasje në të gjitha institucionet kosovare. Serbët shkojnë në komunën e Obiliqit/Obilić, ku i kryejnë të gjitha punët e tyre duke komunikuar në gjuhën serbe. Gjithë dokumentacionin që e marrin nga komuna është në gjuhën e tyre amtare. Ata serbë që i janë drejtuar me shkrim komunës së Obiliqit/Obilić, asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje nga komuna. Sa u përket romëve, ata u drejtohen zyrtarëve komunal në gjuhën serbe ose shqipe.

*Liria e lëvizjes për serbët dhe romët është „e domosdoshme“, me fjalë tjera, ajo ekziston atëherë kur dikujt i duhet të shkojë në komunë ose në ndonjë institucion tjetër, dhe atë më së shpeshti prej orës 09:00 deri në ora 15:00. Blejmë nëpër dyqanet në Obiliq. Në shitore flasim në gjuhën tonë. Sidoqoftë, kur flitet për lirinë e lëvizjes duhet thënë që ajo nuk është e plotë, sepse te njerëzit akoma mbizotëron frika. Unë nuk mund të shkoj lirisht në kafenetë ku shkojnë shqiptarët, sepse nuk ndihem i sigurt. Ka ndodhur disa herë që dikush nga banorët të kthehet në këmbë nga Obiliqi në Plemetin. Nganjëherë ndodh që ata serbë të provokohen dhe shahen nga shqiptarët.*

**D. V. serb nga Plemetini/Plemetine**  
Intervistë e FDH-së, 31 janar 2008

Nxënësit serbë dhe romë shkojnë në shkollat të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Serbisë, ku mësimet mbahen në gjuhën serbe. Ata mjekohen në ambulancat të cilat janë në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë të Qeverisë së Serbisë.

*Rreth 80 për qind e banorëve të Plemetinit para luftime kanë punuar në KEK, d.m.th në Termocentralin Kosova A dhe B, si dhe në mihjet e Belaçevcit dhe*

*Dobro Sellës. Sot, të gjithë këta njerëz, e mes tyre edhe unë, marrim një ndihmë minimale prej 60 euro nga Qeveria e Serbisë. Ne kemi kërkuar dy herë të takohemi me drejtorin e KEK-ut dhe Ministrin e energjetikës në fund të vitit 2007 dhe fillimin e vitit 2008, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Kërkesën e kemi bërë në gjuhën serbe. Kemi kërkuar që të bisedohet për kthimin në punë të punëtorëve të cilët kanë punuar këtu para luftës. Të njëjtën kërkesë ia kemi bërë edhe Qeverisë së Serbisë, nga e cila kemi kërkuar që problemi me KEK-un të zgjidhet në mënyrë institucionale.*

**D. V. serb nga Plemetini/Plemetine**  
Intervistë e FDH-së, 31 janar 2008

Në territorin e komunës së Obiliqit/Obilić mund të dëgjoen radiostacionet të cilat transmetojnë program në gjuhën serbe dhe rome. Serbët dhe romët e Plemetinit/Plemetine nuk kanë informata për punën dhe aktivitetet e komunës, e as për konkurset për vende të punës. Mendojnë se fajtori kryesor për mos informimin e tyre është zyra për komunitete. Në fshat nuk ekziston as tabela e shpalljeve, ku do të mund të lexohen këto njoftime. Për mbledhjet në komunë informohen vetëm nëse ndonjë nga banorët shkon në komunë.

Në komunën e Obiliqit/Obilić punojnë 15 serbë edhe atë dy në PTK, dy në Ujësjellësin Regional Prishtina dhe një në Shtëpinë e Shëndetit - institucion paralel i Qeverisë së Serbisë. Nuk ka asnjë serb apo rom të punësuar në Higjienë dhe KEK. Banorët e Plemetinit/Plemetine i kanë propozuar Higjienës të punësojë pesë banor të fshatit, të cilët do ta pastronin Plemetin/Plemetin, sepse këtu gjendet një lagje johigjienike në të cilën jetojnë romët. Por, ata ende nuk kanë marrë përgjigje konkrete për këtë iniciativë. Banorët kanë shprehur dëshirë ta formojnë kooperativën bujqësore. Kjo nuk është realizuar sepse komuna nuk e ka dhënë listën e pronës për 15 personat iniciatorë dhe theme-lues të ardhshëm të kësaj kooperative.

#### **4.1 Serbët dhe romët në Plemetin/ Plemetine dhe Obiliq/Obilić pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

Pozita e serbëve dhe romëve të Obiliqit/Obilić nuk ka ndryshuar dukshëm pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Serbët akoma janë të kujdesshëm dhe u shmangen vizitave në qytete, për shembull në

Prishtinë/Priština. Problemi më i madh qëndron në ndërprerjen e qarkullimit të »Trenit të lëvizjes së lirë«, përmes së cilës serbët dhe romët i kanë transportuar dhe bartur mallrat e veta në tregjet e pjesëve tjera të Kosovës. Tash ato transportohen me taksi, bileta e të cilave kushton tre euro në një drejtim. Përndryshe, ende nuk është organizuar transporti deri në Plemetin/Plemetine dhe nga Plemetini/Plemetine në vendet tjera. Mosqarkullimi i trenit ka prekur në veçanti banorët e varfër të Plemetinit/Plemetine, në radhë të parë romët, të cilët e kanë shfrytëzuar trenin si mjet transporti për të shkuar në spital për mjekim.

*Është viti i pestë që po e dërgoj vajzën, Valentinën, për dializë në Mitrovicë. Është e domosdoshme që tre herë në javë të bëjë dializën, sepse një veshkë nuk i funksionon fare kurse ekziston rreziku që edhe veshka tjetër të dështojë. Ne jemi shumë të varfër dhe tre vitet e fundit kemi udhëtuar me tren, i cili është i sigurt dhe i lirë. E paguanim biletën deri në Zveçan dhe prej aty shkonim me taksi në spitalin e Mitrovicës veriore. Prej kohës kur treni nuk qarkullon më, Valentinën e dërgon në Mitrovicë auto-ambulanca e Prilluzhës. Shërbimi i tyre është falas, por kemi pasur probleme në rastet kur auto-ambulanca nuk ishte në dispozicion.*

#### **M. K. Rom nga Plemetini/Plemetine**

Intervistë e FDH-së, 2 prill 2008.

Serbët që punojnë në komunën e Obiliqit/Obilić, kanë ardhur në vendet e tyre të punës përmes këtij treni. Meqenëse treni më nuk qarkullon, ata vijnë në punë me taksi ose me dikë që posedon veturë.

Prej 11 serbëve të punësuar në komunën e Obiliqit/Obilić, pas 17 shkurtit të vitit 2008 vetëm njëri e ka lëshuar punën. Megjithatë, dy javët e para pas shpalljes së pavarësisë, te serbët vërehej frika prandaj nuk janë lajmëruar në vendet e tyre të punës. Gjatë gjithë kësaj periudhe e deri më sot, në komunën e Obiliqit/Obilić nuk ka ndodhur asnjë incident i vetëm i motivuar etnikisht. Të gjithë qytetarët e kësaj komune vazhdojnë të kenë qasje të lirë në të gjitha institucionet komunale.

*Pas shpalljes së pavarësisë nuk kishte incidente, sepse kjo do të ishte në dëm të shqiptarëve. Atë ditë,*

*disa shqiptarë kanë kaluar me vetura dhe flamuj të Shqipërisë nëpër Plemetin, por nuk pati incidente. Serbët vazhdojnë të shkojnë në institucionet komunale, si edhe para kësaj date. Unë personalisht do të punoja në institucionet e Kosovës, edhe pse Kosova e ka shpallur pavarësinë, sepse dua të mbetem këtu dhe të punoj për vete dhe për komunitetet tjera pakicë. Kur është në pyetje siguria, pas shpalljes së pavarësisë gjendja mbetet e njëjtë.*

#### **D. V. serb nga Plemetini/Plemetine**

Intervistë e FDH-së, 2 prill 2008

## **Regjioni i Prizrenit/Prizren**

### **1. Turqit në Prizren/Prizren dhe Mamushë/Mamuša**

Pjesa më e madhe e pjesëtarëve të komunitetit turk jeton në regjionin e Prizrenit/Prizren.<sup>10</sup> Ata janë integruar plotësisht në shoqërinë kosovare dhe gëzojnë lirinë e plotë të lëvizjes. Integrimi i tyre është lehtësuar nga fakti se pothuajse të gjithë turqit e flasin gjuhën shqipe. Në regjionin e Prizrenit/Prizren rreth 70 për qind të shqiptarëve flasin turqisht.

Gjatë kryerjes së punëve të përditshme, turqit përdorin si gjuhën turke ashtu edhe atë shqipe. Në komunë turqit u drejtohen zyrtarëve shqiptarë në gjuhën shqipe, kurse zyrtarët komunal komunikojnë me ata në gjuhën turke. Sipas ligjit mbi përdorimin e gjuhëve, në komunën e Prizrenit/Prizren krahas gjuhës shqipe dhe serbe edhe gjuha turke është shpallur gjuhë zyrtare.

Fshati Mamushë/Mamuša është shpallur pilot komunë në vitin 2005. Turqit përbëjnë 98 për qind të popullsisë në Mamushë/Mamuša, prandaj gjuhë e parë zyrtare është gjuha turke, kurse e dyta gjuha shqipe. Turqit e Mamushës/Mamuša nuk janë regjistruar në periudhën 1999-2001, në shenjë proteste sepse gjatë shënimit të emrave të tyre në dokumentet zyrtare të komunës si dhe në dokumentet personale, nuk janë respektuar rregullat drejtshkrimore dhe gramatika e gjuhës turke. Ky gabim është korrigjuar në vitin 2001. Ndërmarrjet publike si KEK-u dhe PTK-ja në

10 Sipas të dhënave të OSBE-së, në regjionin e Prizrenit/Prizren jetojnë 14.067 turq ose 2.81për qind nga numri i përgjithshëm i banorëve në këtë regjion.

dokumentacionin e tyre akoma nuk i respektojnë këto rregulla. Në disa raste, ndodh që turqit në komunën e Prizrenit/Prizren të komunikojnë me zyrtarët në gjuhën turke, kurse përgjigjen apo dokumentin e kërkuar e marrin në gjuhën shqipe.

Dokumentacioni dhe formularët që kanë të bëjnë me hapjen e firmave private, përgatiten në Qendrën për regjistrimin e bizneseve, e cila gjendet në Prishtinë/Priština. Ky dokumentacion është në gjuhën shqipe. Formularët për tatim, të cilët i përgatit komuna e Prizrenit/Prizren, janë në gjuhën shqipe, serbe dhe turke.

Turqit mjekohen në shtëpitë e shëndetit të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës. Komunikimi me mjekët shqiptarë bëhet në gjuhën shqipe, kurse me ata turq në gjuhën turke. Në Mamushë/Mamuša ekziston shtëpia e shëndetit, në të cilën i gjithë dokumentacioni mbahet edhe në gjuhën turke.

*Unë kam butik në Prizren dhe Prishtinë. Gjithë dokumentacioni është në gjuhën shqipe. Formularët për regjistrimin e biznesit dhe pagesës së tatimit janë vetëm në gjuhën shqipe. Vetëm kërkesa për pagesën e taksës vjetore komunale është shkruar në gjuhën shqipe, serbe dhe turke. Këtë dokument e përgatit Drejtoria për ekonomi dhe financa, Sektori i të hyrave publike të Kuvendit komunal të Prizrenit. Gjithë procedurën që ka të bëjë me regjistrimin e biznesit dhe tatimit e kryej në gjuhën shqipe.*

**P. K. turke nga Prizreni/Prizren**  
Intervistë e FDH-së, 20 janar 2008

*Shtëpia e shëndetit dokumentacionin e lëshon në gjuhën turke. Problem kemi pasur me PTK-në, meqenëse, ka refuzuar ta vendos edhe mbishkrimin në gjuhën turke në tabelën në hyrje të ndërtesës, prandaj nuk ju kemi lejuar që tabela të vendoset. Gjithashtu, kemi refuzuar të regjistrohemi për dy vite, sepse nuk kanë pranuar që emrat tonë në dokumentet private të shkruhen në përputhje me rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe. Në fund kanë lëshuar pe, por KEK-u, PTK-ja, Ujës-jellësi si edhe ndërmarrjet tjera publike të cilat ofrojnë shërbime në Mamushë, në faturat e tyre nuk e respektojnë drejtshkrimin e gjuhës turke kur i shkruajnë emrat dhe mbiemrat tonë.*

**R. K. turk nga Mamusha/Mamuša**  
Intervistë e FDH-së, 20 janar 2008

Problem më të madh për banorët e Mamushës/Mamuše paraqet arsimi. Edhe pse në fshat ekziston shkolla fillore ku nxënësit mund t'i ndjekin mësimet në gjuhën amtare, ende vërehet mungesa e librave në gjuhën turke. Nxënësit e shkollave të mesme nuk kanë libra shkollor për asnjë nga lëndët mësimore. Përndryshe, nxënësit e shkollave të mesme nga Mamusha /Mamuša vijojnë shkollën e mesme teknike, ekonomike dhe të mjekësisë dhe gjimnazin në Prizren/Prizren, ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë turke. Në Prizren/Prizren ka edhe shkollë fillore për turqit. Nxënësit turq mund t'i regjistrojnë studimet në gjuhën e tyre amtare në Fakultetin e Mësuesisë në Prizren/Prizren, e cila është degë e Universitetit të Prishtinës, dhe në Seksioni për gjuhën turke dhe orientalistikë në Universitetin e Prishtinës/Priština ku mësimet zhvillohen edhe në gjuhën turke. Turqia ndan bursa dhe i mundëson një grupi të turqve nga Kosova të studiojë në universitetet e atjeshme.

Ndërmarrjet publike PTK-ja dhe KEK-u, faturat dhe dokumentacionin tjetër nuk e ofrojnë në gjuhën turke, por vetëm në gjuhën serbe, angleze dhe shqipe. Faturat e ndërmarrjeve publike të ujës-jellësit dhe higjienës së qytetit, që ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët e Prizrenit/Prizren, janë të përgatitura vetëm në gjuhën shqipe. KEK-u, PTK-ja dhe ndërmarrjet tjera, nuk i respektojnë rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore të gjuhës turke.

Komuniteti turk në regjionin e Prizrenit/Prizren informohet në gjuhën e vet përmes revistës javore *Yeni Donem* dhe televizionit lokal me të njëjtin emër. Gjithashtu, ata përcjellin edhe emisionin informativo-argëtues në gjuhën turke në RTK, në kohëzgjatje prej 60 minutash, i cili transmetohet një herë në javë, dhe lajmet në kohëzgjatje prej 15 minutave që transmetohen nga e hëna deri të shtunën.

## **2. Goranët dhe boshnjakët në Dragash/ Dragaš**

Në komunën e Dragashit/Dragaš jetojnë shqiptarët, goranët dhe boshnjakët. Nga aspekti territorial, komuna e Dragashit ndahet në dy regjione dhe atë regjionin e Gorës, ku kryesisht jetojnë goranët dhe boshnjakët, dhe regjionin e Opojës që banohet nga shqiptarët. Dragashi/Dragaš është qytet multi-etnik. Në Dragash/Dragaš gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe,

serbe dhe boshnjake. Shqiptarët nuk bëjnë dallim mes këtyre dy gjuhëve. Gjuha e goranëve nuk është në përdorim zyrtar sepse nuk është e standardizuar.

Goranët dhe boshnjakët kanë lirinë e plotë të lëvizjes dhe lirisht shkojnë në të gjitha institucionet e komunës. Shumë pjesëtarë të komuniteteve pakicë në komunën e Dragashit/Dragaš e njohin gjuhën shqipe, gjë që u ka ndihmuar atyre të integrohen më shpejtë dhe më lehtë në shoqërinë kosovare. Zyrtarët për komunitete janë mbyllura, sepse të gjitha punët administrative qytetarët goranë dhe boshnjakë i kryejnë drejtpërdrejt në komunë. Me zyrtarët komunal në të gjitha institucionet ata komunikojnë në gjuhën boshnjake ose serbe. Zyrtarët shqiptarë të komunës u përgjigjen pyetjeve të boshnjakëve dhe goranëve në gjuhën në të cilën ata u drejtohen.

*Unë përdor gjuhën boshnjake në komunikim me zyrtarët e institucioneve, sepse nuk e flas gjuhën shqipe. Deri tani, nuk kam pasur probleme dhe nuk kam dëgjuar se ndonjë boshnjak ose goran ka pasur probleme me zyrtarët në institucione për shkak të mosnjohjes së gjuhës shqipe.*

**N.T. boshnjak, Dragash/Dragaš**  
Intervistë e FDH-së, 19 janar 2008

Për qytetarët e Dragashit/Dragaš përkujdesje shëndetësore siguron Shtëpia e shëndetit në Dragash/Dragaš. Në këtë institucion shëndetësor janë të punësuar si boshnjakët ashtu edhe goranët. Megjithatë, gjithë dokumentacioni mjekësor është vetëm në gjuhën shqipe.

Boshnjakët dhe një numër i vogël i goranëve nga komuna, fëmijët i dërgojnë në shkollat të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën boshnjake. Pjesa më e madhe e goranëve i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollat paralele të Qeverisë së Serbisë, ku mësimin e ndjekin në gjuhën serbe, sipas plan programeve të hartuara nga Qeveria e Serbisë.

Faturat të cilat KEK-u ua dorëzon qytetarëve të Dragashit/Dragaša, janë në gjuhën shqipe dhe serbe, derisa faturat për ujë janë vetëm në gjuhën shqipe.

Boshnjakët dhe goranët informohen përmes radios lokale *Gora*, kurse përmes valëve satelitore edhe nga RTS-ja. Kjo radio transmeton informacione edhe për aktualitetet në Kosovë. Qytetarët e Dragashit/Dragaš në asnjë nga mediat nuk mund të informohen për hapjen e vendeve të reja të punës në institucionet komunale, gjykatën komunale, PTK, KEK, ujësjellës dhe *Higjiënë*. Radio *Gora* është përpjekur të marrë informata për aktivitetet e SHPK-së, por deri më tani nuk ia ka dalë mbanë.

Në Dragash/Dragaš nuk arrin sinjali i RTK-së, por qytetarët paguajnë parapagimin për RTK-në, që është përfshirë në faturat e rrymës. Nëse nuk e paguajnë faturën e rrymës, qytetarët nuk mund ta regjistrojnë veturën.

Në qendër të Dragashit/Dragaš gjendet tabela e shpalljeve, në të cilën Kuvendi i komunës shpall informata në gjuhën serbe mbi punën e komunës dhe konkurset për vendet e punës. Të gjitha këto informata i përkasin vitit 2002.

*Ne publikojmë çdo informatë që na dërgon komuna. Problemi qëndron në faktin se valët e radios nuk arrijnë në të gjitha fshatrat ku jetojnë goranët dhe boshnjakët, sepse ne dëgjohe mi vetëm në 13 nga 18 fshatrat që gjenden në regjionin e Gorës. Problem tjetër që pengon transmetimin e programit janë restriksionet e rrymës. Ne jemi media e vetme në komunë që transmeton informata në gjuhën boshnjake për aktualitetet në Kosovë. Problemi që akoma po „zvarritet“ është pagesa e RTK-së në vlerë prej 3.5 euro për programet të cilat ne nuk mund t'i shohim, sepse në Gorë nuk arrin sinjali i RTK-së. Sipas ligjit për RTK-në, ai i cili nuk ka sinjal nuk e ka për detyrë të paguaj taksën, por KEK-u nuk çan kokën për këtë absurditet dhe në faturat e tyre vazhdojnë ta faturojnë edhe taksën prej 3.5 euro për RTK-në. Shumica nga ne, që nuk deshëm ta paguajmë taksën për RTK-në, u ballafaquam me ndërprerjen e rrymës. Problemi u bë edhe më i madh pas vendimit për të dëshmuar pagesën e rrymës si kusht për regjistrimin e automjeteve, prandaj njerëzit janë detyruar ta paguajnë taksën për sinjalin e RTK-së, të cilin nuk e kemi.*

**N.T. boshnjak, Dragash/Dragaš**  
Intervistë e FDH-së, 19 janar 2008

### **3. Serbët në fshatin Mushnikovë/ Mušnikovo deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës**

Mushnikova/Mušnikovo është fshat multietnik në të cilin jetojnë rreth 2000 banorë: 90 serbë, 80 boshnjakë dhe rreth 1.800 shqiptarë. Serbët pohojnë se si në këtë fshat, ashtu edhe në gjithë regjionin e Prizrenit/Prizren ata gëzojnë lirinë e plotë të lëvizjes. Për dallim nga bashkëkombësit e tyre në pjesë tjerë të Kosovës, serbët në regjionin e Prizrenit/Prizren e shfrytëzojnë pa problem transportin publik.

Në fshat ekziston zyra për komunitete, por krahas kësaj serbët kërkojnë shërbime drejtpërdrejt edhe nga komuna e Prizrenit/Prizren. Komunikimi me komunën zhvillohet në gjuhën serbe. Të gjitha dokumentet e kërkuara nga komuna i marrin në gjuhën e tyre amtare. E njëjta gjë vlen edhe për gjykatën komunale dhe atë të qarkut në Prizren/Prizren. Për herë të parë pas qershorit të vitit 1999, serbët kanë përfaqësuesit e tyre në komunën e Prizrenit/Prizren. Ata mendojnë se ky fakt do të jetë shumë i dobishëm.

As në komunën e Prizrenit/Prizren e as Mushnikovë/Mušnikovo nuk ka shkollë ku nxënësit serbë do të mund të shkollohen në gjuhën e tyre. Përndryshe, në fshat nuk ka nxënës të moshës së shkollës fillore, por ka dy nxënës të shkollës së mesme. Ata vijojnë mësimet në Shtërpçë/Štrpce, që ndodhet 30 kilometra larg.

Në fshat ka dy ambulanca, njëra në kompetencë të Qeverisë së Serbisë, tjetra në kompetencë të Qeverisë së Kosovës. Serbët shfrytëzojnë shërbimet e të dy ambulancave. Nëse shfaqet nevoja për hospitalizim ata shkojnë për mjekim në spitalet në Serbi.

Në gjithë regjionin e Prizrenit/Prizren serbët shfrytëzojnë shërbimet e KEK-ut. Faturat janë në gjuhën serbe.

Banorët serbë të Mushnikovës/Mušnikovo, kryesisht informohen nga programet e RTS-së, të cilin e ndjekin përmes valëve satelitore. Edhe pse paguajnë taksën për RTK, serbët nuk mund ta përcjellin këtë televizion për shkak se në regjionin e tyre nuk ka sinjal të RTK-së. Formë tjetër e informimit është edhe përmes tabelës së shpalljeve në zyrën për komunitete në Mushnikovë/Mušnikovo. Në tabelat e shpalljeve ka

informata në gjuhën serbe, ku përpos tjerash ka edhe lajmërimi për vende të lira të punës.

*Këtu në fshat nuk vjen shtypi në gjuhën serbe. Mund t'i përcjellim kanalet televizive të Serbisë, në radhë të parë RTS-në, por vetëm përmes valëve satelitore. Edhe pse në kuadër të faturës për rrymë paguajmë edhe taksën prej 3.5 euro për RTK, nuk kemi sinjal të RTK-së. Do të thotë se ne paguajmë por nuk mund t'i shohim programet e RTK-së.*

**T. V. serb nga fshati Mushnikovë/Mušnikovo**  
Intervistë e FDH-së, 5 mars 2008

### **3.1 Serbët në Mushnikovë/Mušnikovo dhe Prizren/Prizren pas shpalljes së pavarësisë**

Pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt të këtij viti, gjendja e serbëve në fshatin Mushnikovë/Mušnikovo dhe në Prizren/Prizren fare nuk ka ndryshuar. Serbët kanë lirinë e plotë të lëvizjes dhe kur komunikojnë me institucione flasin në gjuhën e tyre. Asnjë nga serbët e punësuar në institucionet komunale nuk e ka lëshuar vendin e tij të punës.

*Unë akoma punoj në zyrën për komunitete në fshatin Mushnikovë. Nuk e kam ndërprerë punën për asnjë moment dhe as nuk do ta ndërpres. Le të luftojnë ata që duan të luftojnë – unë nuk dua. Dy serbë nga fshati ynë janë ftuar ex officio të marrin pjesë në punën e Kuvendit të komunës së Prizrenit dhe atje t'i përfaqësojnë interesat e komunitetit serb. Ata vazhdojnë të shkojnë në mbledhje, sa herë që ftohen.*

**T.V. serb nga fshati Mushnikovë/Mušnikovo**  
Intervistë e FDH-së, 11 prill 2008

## **Regjioni i Gjilanit/Gnjilane**

### **1. Serbët në komunën e Gjilanit/Gnjilane dhe fshatin Babushi Serb/Srpski Babuš deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës**

Serbët në komunën e Gjilanit/Gnjilane dhe në fshatin Babushi Serb/Srpski Babuš, në komunën e Ferizajt/Uroševac, kanë lirinë e plotë të lëvizjes. Fshati Babushi

Serb/Srpski Babuš është fshat i të kthyerve, në të cilin serbët kanë filluar të kthehen në vitin 2006. UNDP-ja ka ndërtuar 75 shtëpi për 300 të kthyer. Pjesëtarët e SHPK-së i vizitojnë ata rregullisht dhe kanë marrëdhënie të mira me serbët.

Serbët shkojnë në Graçanicë/Gračanica, Mitrovicë/Mitrovica ose Prishtinë/Priştine ku edhe kryejnë tregtinë, kryesisht me taksitë private të serbëve ose me automjetet e tyre private, të cilat kanë tabelat e regjistrimit «KS». Numri i serbëve që shfrytëzojnë trafikun publik është gjithnjë e më i madh. Në vendimin për të shfrytëzuar transportin publik ka ndikuar edhe fakti se çmimi i këtyre autobusëve është gjysmë euro, përderisa në autobusët serbë bileta kthyes kushton 15 euro. Serbët të cilët e shfrytëzojnë trafikun publik i marrin biletat nga vozitësi dhe me të komunikojnë në gjuhën serbe. Deri më tani nuk kanë pasur probleme të sigurisë

Megjithatë, akoma janë të rralla rastet kur serbët u drejtohen institucioneve kosovare, dhe punët e veta administrative i kryejnë kryesisht përmes zyrave për komunitete, të cilat gjenden në fshatrat Budrigë e Poshtme/Donja Budriga dhe Pasjan/Pasjane. Mirëpo, ka serbë të cilët punët e tyre i kryejnë drejtpërdrejt në komunat Gjilan/Gnjilane dhe Ferizaj /Uroševac. Në komuna kanë nxjerrë letërnjoftimet e UNMIK-ut dhe dokumentet tjera. Në kontakt me zyrtarët komunal dhe gjykatave shprehen në gjuhën e tyre amtare. Në përgjithësi, zyrtarët komunal komunikojnë me ata në gjuhën serbe. Dokumentet lëshohen në gjuhën serbe, në alfabetin latin. Nëse institucioneve u drejtohen me shkrim, përgjigjen e marrin në gjuhën serbe, në përputhje me rregullat drejtshkrimore dhe gramatikore të gjuhës së tyre.

*Përvoja ime e vetme me policinë ka qenë kur më kanë ndalë pjesëtarët e SHPK-së të Gjilanit. Ishin dy shqiptarë. Ata kanë folur shqip kurse unë ua ktheva serbisht. Edhe pse me mua u sollën mirë, ata nuk folën asnjë fjalë në serbisht. Nuk më besuan kur u thash që jetoj këtu që 18 vjet. Paramendoni, më përçollën me veturën e tyre deri në shtëpi, për t'u siguruar se ato që unë u thash janë të vërteta.*

**R.Ž. serb nga Gjilani/Gnjilane**  
Intervistë e FDH-së, 19 janar 2008

*T'ju them të vërtetën, gjendja tash është shumë më e mirë. Liria e lëvizjes ekziston. Unë vij shpesh në Gjilan dhe nuk kam asnjë problem. Kemi qasje në*

*institucione, edhe pse unë pothuajse gjithmonë i kryej punët përmes zyrës për komunitete e cila ndodhet në Budrigë të Poshtme.*

**V.S. serb nga fshati Budrigë e Poshtme, komuna e Gjilanit/Gnjilane**

Intervistë e FDH-së, 21 janar 2008

*Të jem i sinqertë, unë nuk kam pasur shumë nevojë t'i drejtohem shërbimit komunal, por kur paraqitet nevoja shkoj në komunë dhe i kryej punët pa ndonjë problem të madh. Në komunë komunikoj në gjuhën serbe. Zyrtarët komunal përgjigjen në të njëjtën gjuhë. Aty punojnë edhe zyrtarë të komunitetit serb.*

**R.Ž. serb nga Gjilani/Gnjilane/**  
Intervistë e FDH-së, 19 janar 2008

Serbët mësojnë vetëm në shkollat që janë institucione paralele të Qeverisë së Serbisë, sipas planeve dhe programeve të cilat përdoren në Serbi. Qeveria e Kosovës, në fshatin Babushi Serb/Srpski Babuš e ka ndërtuar shkollën, por meqenëse fëmijët nuk janë kthyer akoma, ajo nuk ka filluar ende të punojë.

Serbët shfrytëzojnë shërbimet e mjekëve të cilët punojnë në ambulancat serbe, të cilat janë në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë të Qeverisë së Serbisë. Në rast të sëmundjeve serioze, serbët dërgohen në spitalet e Graçanicës/Gračanica, Lapllasellës/Laplje Selo dhe Mitrovicës/Mitrovica, sikurse edhe nëpër spitalet e Serbisë në Nish, Vranjë, Leskovc dhe Beograd. Në raste urgjente, serbët kërkojnë ndihmë mjekësore në shtëpitë e shëndetit në Ferizaj/Uroševac dhe në Gjilan/Gnjilane. Thonë se në këto institucione trajtohen mirë dhe me mjekët flasin në gjuhën e tyre amtare.

Një nga arsytet pse serbët nuk i frekuentojnë më shpesh institucionet shëndetësore kosovare është participimi që duhet të paguhet në këto institucione, përderisa ekzaminimi mjekësor në ambulancat serbe është pa pagesë.

Serbët nga Babushi Serb/Srpskog Babuša dhe fshatrat tjera në regjionin e Gjilanit/Gnjilane nuk e paguajnë rrymën dhe nuk pranojnë fatura. Këtë shpenzime në emër të tyre i heq organizata *Perspektiva Evropiane*, nga viti 2006. godine. Kjo organizatë do të bëjë pagesën e faturave të rrymës për serbët deri në vitin 2008.

Nga ana tjetër, serbët të cilët jetojnë në qytetin e Gjilanit/Gnjilane e paguajnë rregullisht rrymën si dhe

shërbimet tjera komunale. Të gjitha faturat të cilat i marrin janë edhe në gjuhën serbe. Komunikimi me të gjitha ndërmarrjet publike bëhet në gjuhën e tyre amtare.

Serbët kryesisht informohen përmes programeve të RTS-së, por përcjellin gjithashtu edhe programin e RTK-së në gjuhën serbe. Disa serbë, të cilët e kuptojnë gjuhën shqipe, përcjellin kanalet tjera televizive në shqip si për shembull RTV 21, KOHA TV dhe RTK-në. Serbët informohen edhe nga informatat të cilat janë të ngjitura në tabelat e shpalljeve, në zyrat për komunitete. Mirëpo, nuk janë të kënaqur me këtë formë të informimit. Shtypin pothuajse nuk e lexojnë fare. Vetëm një numër i vogël i serbëve e shfrytëzojnë internetin si formë e informimit. Internetin e shfrytëzojnë zakonisht serbët që jetojnë në qytete.

Serbët nga komuna e Gjilanit/Gnjilane dhe fshatit Babushi Serb/Srpski Babuš kryesisht janë të punësuar në institucionet paralele të Qeverisë Serbisë. Megjithatë, gjithsej 53 serbë janë të punësuar në Kuvendin e komunës së Gjilanit/Gnjilane.

### **1.1 Serbët në komunën e Gjilanit/ Gnjilane dhe fshatin Babushi Serb/ Srpski Babuš pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

Pozita e komunitetit serb në komunën e Gjilanit/Gnjilane, dhe në vet fshatin Babushi Serb/Srpski Babuš nuk ka ndryshuar pas 17 shkurtit të vitit 2008. Serbët edhe më tej gëzojnë lirinë e lëvizjes. Disa nga ata, si për shembull serbët nga fshati Babushi Serb/Srpski Babuš, shfrytëzojnë transportin publik për qarkullim. Ekziston qasje e lirë në të gjitha institucionet si në Gjilan/Gnjilane ashtu edhe në Ferizaj/Uroševac.

Në komunën e Gjilanit/Gnjilane punojnë 40 serbë, nga të cilët 13 në zyrën për komunitete e cila gjendet në fshatin Kufcë e Epërme/Gornje Kusce, përdërisa 27 të tjerët punojnë në administratën e komunës që ndodhet në qytetin e Gjilanit/Gnjilane. Pas 17 shkurtit 2008, vetëm dy punëtorë të komunitetit serb e vijnë punën në institucionet komunale të cilat ndodhen në qytet. Të tjerët nuk paraqiten në punë për shkaqe sigurie. Për këta serbë komuna ka organizuar transportin me minibus dhe taksì, por ata vazhdojnë ta bojkotojnë punën.-

*Kemi biseduar me ata përmes telefonit dhe na kanë thënë se nuk vijnë në punë sepse nuk ndihen të sigurt. Gjendja faktike tregon të kundërtën, sepse komuna ka organizuar minibus, i cili që nga fillimi i ka transportuar serbët e punësuar deri në punë dhe i ka kthyer në shtëpi në fshatrat Shilovë, Kufcë e Epërme, Koretish, Makresh, derisa për një punëtor nga fshati Livoç komuna ka paguar taksì. Qytetarët tjerë të komunitetit serb vazhdojnë të vijnë në komunë për shkak të nevojave të ndryshme sikurse edhe para 17 shkurtit të vitit 2008. Ky është edhe një argument më shumë i cili nuk shkon në favor të pohimeve të serbëve të punësuar në komunën e Gjilanit të cilët, sipas mendimit tim, kanë problem me pranimin e realitetit. Komuna akoma nuk ka ndërmarrë kurrfarë masash ndaj serbëve të cilët e bojkotojnë punën, sepse ky është një problem politik. Ata janë akoma në listat tona të rrogave.*

### **S.O. shef i administratës së burimeve njerëzore në Kuvendin e komunës së Gjilanit/Gnjilane** Intervistë e FDH-së, 2. prill 2008

Një banor i fshatit Babushi Serb/Srpski Babuš vazhdon të punojë në zyrën për komunitete në Ferizaj/Uroševac.

### **1.2 Serbët në komunën e Novobërdës/ Novo Brdo pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

Sipas informatave të cilat i ka marrë FDH – Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë më 17 shtator të vitit 2008, serbët kanë themeluar Kuvendin komunal paralel të Novobërdës/Novo Brdo në fshatin Prekoc/Prekovce, në ambientet e zyrës së dikurshme për komunitete. Të gjithë kolegët serbë dhe shqiptarë janë në raporte të mira dhe takohen për çdo ditë. Serbët, që janë zyrtar komunal, shkojnë në zyrat e tyre për të pirë kafe me kolegët shqiptarë, por nuk qëndrojnë aty për të punuar. Shumë zyrtarë serbë pohojnë se Qeveria e Serbisë ushtron presion ndaj tyre që të mos kthehen në punë, përmes disa bashkëkombësve të tyre që kanë reputacion të mirë në komunë.

Deri më 17 shkurt 2008, në komunën e Novobërdës/Novo Brdo kanë punuar 31 serbë, 27 shqiptarë dhe 1 rom. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në punë nuk paraqiten punëtorët e komunitetit serb dhe rom. Kryetari i komunës i ka lajmëruar të gjithë punëtorët

që nuk vijnë në punë, se kontratat e tyre të punës vlej-  
jnë deri më 31 mars të vitit 2008, dhe është e domos-  
doshme prezenca e tyre për vazhdimin e kontratave.  
Serbët janë akoma në listën për pagesën e rrogave,  
por nuk i kanë marrë të ardhurat për ditët që nuk  
kanë punuar.

*Unë kam biseduar personalisht me 90 për qind të  
punëtorëve që nuk vijnë në punë dhe më kanë thënë se  
ata duan të punojnë mirëpo Qeveria e Serbisë, përmes  
ish kryetarit të komunës P.V. ushtron presion që ata të  
mos punojnë në institucionet e Kosovës. Na kanë prem-  
tuar se të hënën do të marrin vendim definitiv nëse do  
të kthehen në punë ose jo. Nëse nuk kthehen, ne do t'i  
largojmë nga lista e rrogave dhe do t'i shkarkojmë. Në  
vendimin e tyre ka ndikim edhe mbështetja e Ministrisë  
për Kosovë dhe Metohi, Samarxhić, i cili katër ditë më  
parë ka mbajtur një miting publik në objektin e shkollës  
Bostane, ku u ka premtuar krijimin e komunës  
serbe, respektivisht u dha instruksione për të formuar  
institucione paralele në territorin e komunës tonë.*

**R.M. zëvendës i kryetarit të KK të Novobërdës/  
Novo Brdo**

Intervistë e FDH-së, 4 prill 2008

### **1.3 Serbët në komunën e Kamenicës/ Kamenica pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

Pozita e komunitetit serb në Kamenicë/Kamenica nuk  
ka ndryshuar pas 17 shkurtit 2008. Serbët kanë lirinë  
e plotë të lëvizjes dhe qasje të lirë në të gjitha institu-  
cionet komunale.

Në komunën e Kamenicës/Kamenica janë të punë-  
suar 48 punëtorë të komunitetit serb. Serbët nuk janë  
paraqitur në punë dy javë pas shpalljes së pavarësisë  
së Kosovës. Javën e tretë janë lajmëruar 45 prej tyre,  
derisa tre të tjerë kanë vendosur që më të mos vijnë  
në punë. Një prej tyre në ndërkohë ka gjetur një vend  
tjetër të punës

## **2. Romët në lagjen Avdullah Presheva/ Avdulah Preševa në Gjilan/Gnjilane**

Momentalisht në lagjen Avdullah Presheva/Avdulah  
Preševa të Gjilanit/Gnjilane jetojnë rreth 30 familje  
rome. Të gjitha familjet pas qershorit të vitit 1999

janë shpërngulur, por janë kthyer përsëri duke filluar  
nga viti 2002. Të gjithë romët flasin gjuhën serbe,  
kurse shumica edhe atë shqipe. Ata kanë lirinë e plotë  
të lëvizjes dhe lëvizin lirisht në gjithë territorin e  
Kosovës, duke shfrytëzuar transportin publik. Romët  
nuk kanë vërejtje për sa i përket punës së SHPK-  
së. Për shkak të vjedhjeve të shpeshtuara në lagjen  
Avdullah Presheva /Avdulah Preševa, me kërkesë të  
komunitetit rom SHPK-ja ka shtuar numrin e patrol-  
limeve.

Romët shkojnë plotësisht të lirë në komunë dhe  
grykatë, por nuk mund t'u drejtohen zyrtarëve komu-  
nal në gjuhën e tyre sepse ata nuk e njohin gjuhën  
rome dhe nuk ka përkthyes. Në tabelat e shpalljeve  
në komunën e Gjilanit/Gnjilane asnjë informatë e  
vetme nuk është në gjuhën rome, por ekskluzivisht në  
gjuhën serbe dhe shqipe. Përgjigjen e marrin në atë  
gjuhë në të cilën i drejtohen zyrtarit komunal.

*Unë e përdor transportin publik në mënyrë që të shkoj  
në Prishtinë dhe Fushë Kosovë. E pres autobusin,  
paguaj biletën dhe gjithçka është në rregull. Asnjëherë  
nuk më ka ndodhur të kem probleme me udhëtarët  
tjerë, e as nuk ka ngjarë që dikush të më ofendoj. Unë  
dallohem lehtë që jam rom, por deri tani nuk kam  
pasur ndonjë problem për shkak të përkatësisë time  
kombëtare.*

**S.Q. rom nga Gjilani/Gnjilane**

Intervistë e FDH-së, 19 janar 2008

*Në komunë kam shkuar disa herë. Natyrisht, asnjë  
mbishkrim nuk është në gjuhën rome, por është në  
gjuhën serbe, kështu që mund të gjendem. Unë kam  
dokumente të vjetra serbe, por e nxora edhe letërnjofti-  
min e UNMIK-ut. Nuk kisha problem...*

**B.B. rom nga Gjilani/Gnjilane**

Intervistë e FDH-së, 19 janar 2008

Shumica e romëve në Gjilan/Gnjilana shkollohen në  
shkollat serbe, në gjuhën serbe. Mësimi për romët  
në gjuhën e tyre amtare nuk është organizuar as në  
shkollat në kompetencë të Qeverisë së Serbisë, e as në  
ato të Qeverisë së Kosovës.

Romët shfrytëzojnë njëllonj si shërbimet institucioneve  
shëndetësore paralele të Qeverisë së Serbisë ashtu  
edhe shtëpitë e shëndetit në kompetencë të Qeverisë  
së Kosovës. Në të gjitha ambulancat mjekët sillen në  
mënyrë korrekte me ata. Megjithatë, në radhë të parë  
për shkak të varfërisë, romët shkojnë më shumë në

ambulancat serbe sepse aty nuk duhet të paguhet participimi për ekzaminim mjekësor. Ndodh që zyrtarët e Shtëpisë së shëndetit në Gjilan/Gnjilane i lirojnë nga participimi romët që janë raste sociale.

*Në shfrytëzime shërbimet e Shtëpisë së shëndetit në Gjilan. Mirë na presin atje. Megjithatë, shpesh fëmijët i dërgoj në ambulancën serbe, sepse kontrolli dhe barnat janë pa pagesë. Në shtëpitë e shëndetit të shqiptarëve duhet të paguhet participimi.*

**B.B. rom nga Gjilani/Gnjilane**  
Intervistë e FDH-së, 19 janar 2008

Faturat të cilat romët i marrin nga KEK-u, PTK-ja dhe ndërmarrjet tjera publike, gjithashtu nuk janë në gjuhën rome, por vetëm në gjuhën serbe dhe shqipe.

Romët kryesisht informohen nga programet e RTK-së në gjuhën rome, ata përcjellin emisionin *Yekipe*, i cili transmetohet një herë në javë, të enjten në ora 17.15 dhe zgjat 60 minuta, por edhe nga radio dhe televizionet në gjuhën shqipe, si RTK ose ato lokale TV Vali. Romët gjithashtu përcjellin edhe programet e RTS-së.

Romët informohen për aktivitetet në komunë ose për vendet e punës përmes informacioneve në tabelat për shpallje në komunë.

Shumica e romëve nuk janë të punësuar dhe marrin ndihmë sociale që sillet prej 35 deri 65 euro.

### 3. Turqit në Gjilan/Gnjilane

Në komunën e Gjilanit/Gnjilane jetojnë rreth 1.000 turq. Pjesëtarët e këtij komuniteti janë plotësisht të integruar në shoqërinë kosovare. Ata gjithmonë kanë pasur lirinë e plotë të lëvizjes. Pa kurrfarë problemi shkojnë në të gjitha institucionet e Kosovës dhe ndërmarrjet publike. Gjithashtu, të gjithë turqit flasin edhe gjuhën shqipe.

Më 14 qershor 2007, Kuvendi komunal i Gjilanit/Gnjilane ka sjellë vendimin që përpos gjuhës shqipe dhe serbe edhe gjuha turke të jetë gjuhë zyrtare në komunë. Megjithatë, ky vendim nuk po zbatohet në praktikë. Të gjitha informatat në komunë akoma janë vetëm në gjuhën serbe ose shqipe. Nuk është punësuar përkthyesi për gjuhën turke. Nga ana tjetër, zyrtarët komunal nuk e flasin turqishten, prandaj turqit

në komunë flasin në gjuhën shqipe. Dokumentet të cilat turqit i marrin nga komuna janë në gjuhën shqipe, kurse emrat turq janë shkruar sipas rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore të gjuhës shqipe. E njëjtë është gjendja edhe me faturat të cilat i marrin nga ndërmarrjet publike.

*Në vitin 2001, kur filloi regjistrimi, ne ia tërhoqëm vërejtjen OSBE-së për shkrimin jo të drejtë të emrave të pjesëtarëve të komunitetit turk, ata kanë reaguar dhe i kanë përmirësuar gabimet e bëra. Sot, zyrtarët komunal bëjnë të njëjtat gabime. Ne vazhdimisht ua tërhoqim vërejtjen për këtë problem, por marrim përgjigje se kjo ndodh për shkak të problemeve teknike dhe ata nuk mund të bëjnë asgjë në këtë drejtim, çka nuk është e vërtetë. Kulmi i mos respektimit të të drejtave ka ngjarë gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare dhe lokale, kur në qytetin tonë nuk kishte as edhe një informatë të vetme në gjuhën turke në lidhje me zgjedhjet. Madje, as fletëvotimet, e as udhëzimet për mënyrën e votimit nuk ishin në gjuhën turke. Në qytet nuk mund të shihni shpallje, informata, lajmërimi ose ftesa të përgatitura në gjuhën turke.*

**N.G. turke nga Gjilani/Gnjilane**  
Intervistë e FDH-së, 15 shkurt 2008.

Qeveria e Kosovës ka përgatitur planin dhe programin për arsimin në shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën turke. Në Gjilan/Gnjilane ekzistojnë shkolla fillore dhe të mesme në të cilat turqit mund të arsimohen në gjuhën e tyre amtare. Këto shkolla janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës.

Pjesëtarët e komunitetit turk shkojnë në shtëpitë e shëndetit në kompetencë të Qeverisë së Kosovës. Komunikimi me mjekët bëhet në gjuhën shqipe, meqenëse ata nuk e njohin gjuhën turke. Asnjë informatë në këto institucione nuk është në gjuhën turke.

Turqit informohen përmes lajmeve të RTK-së në gjuhën turke, të cilat transmetohen gjashtë herë në javë, prej të hënës deri të shtunën, në kohëzgjatje prej 15 minutash dhe përmes emisionit informativ-argëtues *Mozaik*, i cili transmetohet një herë në javë, ditën e shtunë në ora 12:00, në kohëzgjatje prej 60 minutave. Turqit në Gjilan/Gnjilane i përcjellin edhe disa medime private që gjithashtu transmetojnë program në gjuhën turke. Meqenëse turqit e njohin gjuhën shqipe, ata i përcjellin edhe mediat në gjuhën shqipe. Një numër i vogël i turqve janë të punësuar në Kuvendin e komunës në Gjilan/Gnjilane. Gjithsej

në Kuvendin e komunës së Gjilanit/Gnjilane janë të punësuar katër pjesëtarë të komunitetit turk.

#### **4. Shqiptarët në komunën e Shtërpçës/ Štrpce deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës**

Në komunën e Shtërpçës/Štrpce shqiptarët janë pakicë. Ata jetojnë në nëntë fshatra, prej të cilave katër janë etnikisht të pastra shqiptare, kurse pesë kanë strukturë të përzier etnike. Të gjithë banorët gëzojnë lirinë e lëvizjes. Shqiptarët shkojnë lirish në Shtërpçë/Štrpce për t'i kryer punët që kanë. Patrullat e SHPK-së i vizitojnë të gjitha fshatrat dhe gjithmonë janë etnikisht të përziera, të përbëra nga serbë dhe shqiptarë.

Komuna nuk e ka organizuar transportin publik, prandaj shqiptarët i shfrytëzojnë taksitë për të shkuar në qytetin e Ferizajt/Uroševac, i cili është shumë afër këtyre pesë fshatrave në të cilat jetojnë shqiptarët.

Në komunën e Shtërpçës/Štrpce funksionon shërbimi për përkthim, prandaj të gjitha mbledhjet përkthehen në gjuhën shqipe dhe gjithashtu, gjithë dokumentacioni është edhe në këtë gjuhë.

Në fshatin Drajkofc/Drajkovce jetojnë serbët dhe shqiptarët. Në fshat ekziston zyra për komunitete. Arsyeja për hapjen e kësaj zyre është mungesa e hapësirave në komunën e Shtërpçës/Štrpce si dhe fakti se Drajkofci/Drajkovce gjendet në afërsi të fshatrave tjera të banuara me shqiptarë. Përpos kësaj zyre është hapur edhe shërbimi i ofiqarisë si dhe qendra për regjistrim civil, në fshatin Brod/Brod ku gjendet edhe zyra për çështje sociale.

Shqiptarët të cilët jetojnë në fshatrat e komunës së Shtërpçës/Štrpce shfrytëzojnë shërbimet e dy shtëpive të shëndetit, të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, njëra është në fshatin Brod/Brod kurse tjetra në Drajkofc/Drajkovce. Në rast të problemeve më serioze shëndetësore shqiptarët kërkojnë ndihmë mjekësore në spitalin e Ferizajt/Uroševac. Në fshatin Drajkofc/Drajkovce në po të njëjtin objekt punon edhe ambulanca që është në kompetencë të Qeverisë së Serbisë.

*Deri tani, nuk kemi pasur ndonjë problem të madh edhe pse bashkërisht i shfrytëzojmë të njëjtat hapësira. I vetmi problem është se serbët punojnë deri në ora 12:00 dhe shqiptarët duhet ta lëshojnë objektin po në këtë kohë, sepse çelësat e ambulancës i mbajnë mjekët serbë. Serbët më tepër kërkojnë ndihmë në Shtëpinë e shëndetit në Shtërpçë, kurse shqiptarët shkojnë në Ferizaj ose Kaçanik.*

**A. H. shqiptar nga fshati Drajkofc/ Drajkovac**  
Intervistë e FDH-së, 5 shkurt 2008

Fëmijët shqiptarë të komunës së Shtërpçës/Štrpce vijnë në mesimin fillor dhe të mesëm në shkollën që ndodhet në fshatin Firajë/Firaje. Kjo është shkolla e vetme në komunë ku nxënësit shqiptarë mund të vijnë në mesimin në shkollat në kompetencë të Qeverisë së Kosovës.

Zyra e KEK-ut për komunën e Shtërpçës/Štrpce gjendet në fshatin Firajë/Firaje. Përderisa shumica e shqiptarëve e paguajnë rrymën, serbët nuk e paguajnë atë fare.

PTK-ja nuk funksionon në territorin e komunës Shtërpçë/Štrpce. PTT-ja e Serbisë ofron rrjetin e telefonisë fikse.

Në këtë regjion nuk arrijnë valët e RTK-së e as të medimeve tjera në gjuhën shqipe.

*Kur bëhet fjalë për informim, ne jemi në errësirë informative sepse këtu nuk arrijnë sinjalet e radio televizioneve, por nuk vijnë as gazetat në gjuhën shqipe. Media e vetme është RTV Herc që transmeton program vetëm në gjuhën serbe. Internet caffè ka vetëm në fshatin Firajë.*

**A.H. shqiptar nga fshati Drajkofc/Drajkovac**  
Intervistë e FDH-së, 5 shkurt 2008

Në fshatrat shqiptare nuk ka tabela për shpallje, ku do të mund të publikohen informata në lidhje me vendet e lira të punës dhe aktivitetet e komunës. Tabela për shpallje ekziston vetëm para komunës së Shtërpçës/Štrpce dhe informatat e publikuara aty janë edhe në gjuhën shqipe. Komuna nuk posedon buletinin e vet.

Në komunën e Shtërpçës/Štrpce, 60 për qind e popullsisë janë raste sociale. Në Kuvendin e komunës së Shtërpçës/Štrpce punojnë 27 shqiptarë, 18 në SHPK, tre në ndërmarrjen publike komunale *Higjiëna*, tre në zyrën e KEK-ut në fshatin Firajë/Firaje, katër në ambulancën e fshatit Brod/Brodec dhe tetë në ambulancën

e Drajkofcit/Drajkovac. Me përjashtim të komunës, shqiptarët nuk janë të punësuar në asnjë institucion tjetër publik në qytetin e Shtërpcës/Štrpce. Një numër i vogël i shqiptarëve merret me bujqësi dhe nuk kanë probleme kur e punojnë tokën, si arat që janë pranë ashtu edhe ato larg fshatit.

#### **4.1 Shqiptarët në komunën e Shtërpcës/ Štrpce pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

Në komunën e Shtërpcës/Štrpce janë të punësuar 65 punëtorë dhe atë: 44 zyrtarë të kombësisë serbe dhe 21 shqiptarë. Pas 17 shkurtit 2008, zyrtarët serbë kanë vazhduar të shkojnë në punë, disa prej tyre nuk janë të rregullt, por në përgjithësi, refuzojnë t'u shërbejnë të gjithë qytetarëve të kësaj komune. Për dallim nga ata, punëtorët shqiptarë shkojnë rregullisht në punë dhe u ofrojnë shërbime të gjithë qytetarëve.

## **Regjioni i Mitrovicës/ Mitrovica**

### **1. Shqiptarët në komunat Zubin Potok/ Zubin Potok dhe Leposaviq/Leposavić deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës**

Shqiptarët janë pakicë në komunat e pjesës veriore të Kosovës. Fshati më i madh shqiptar në këtë pjesë të Kosovës është Çabra/Čabra, që ndodhet në komunën e Zubin Potokut/Zubin Potok. Në këtë fshat jetojnë rreth 2000 shqiptarë. Fshatrat tjera në të cilat jetojnë shqiptarët gjenden në komunën e Leposaviqit/Leposavić në Bistricë/Bistrica, Cerajë/Ceraje dhe Koshtovë/Koštova. Në këto fshatra jetojnë rreth 1500 shqiptarë. Rreth 70 për qind e popullsisë së këtyre fshatrave janë raste sociale. Një numër i madh i banorëve është shpërngulur në Mitrovicën/Mitrovica jugore, në radhë të parë për shkak të mungesës së sigurisë dhe perspektivës.

Në përgjithësi, banorët shqiptarë të këtyre fshatrave nuk kanë lirinë e lëvizjes. Raportet me SHPK-në janë të mira, por ka probleme në komunikim, sepse policët

që patrollojnë këto vise janë serbë ose boshnjakë dhe nuk e flasin gjuhën shqipe.

Katër herë në javë, nga dy herë në ditë, banorët e Cerajës/Ceraje udhëtojnë në mënyrë të organizuar deri në Mitrovicë/Mitrovica. Ata nuk janë të kënaqur me këtë mënyrë të transportit sepse është e pamjaftueshme për t'i kryer punët që i kanë në Mitrovicë/Mitrovica. Transporti prej Çabrës/Čabre deri në Mitrovicë/Mitrovica organizohet çdo ditë, nga pesë herë në ditë, kurse nga fshatrat Cerajë, Koshtovë/Koštovo dhe Bistricë/Bistrica katër herë në javë, nga dy herë në ditë.

Përndryshe, të gjitha punët administrative shqiptarët i kryejnë përmes zyrave për komunitete të cilat ndodhen në fshatrat Çabër/Čabra dhe Bistricë/Bistrica. Në këto zyre punojnë vetëm shqiptarët. Në komunat Leposaviq/Leposavić dhe Zubin Potok/Zubin Potok, si dhe në gjykatat komunale, ata shkojnë shumë rrallë dhe atë vetëm në përcjellje të policisë dhe përfaqësuesve të zyrës për komunitete. Në rrethana të tilla, me zyrtarët mund të bisedojnë vetëm në gjuhën serbe, sepse zyrtarët njohin vetëm gjuhën serbe, kurse në komunë nuk është punësuar asnjë përkthyes për gjuhën shqipe.

Në gjykatë ata shërbehen në gjuhën e tyre, ndërsa sipas nevojës mund të kërkojnë shërbimet e përkthyesit të punësuar. Në Leposaviq/Leposavić dhe Zubin Potok/Zubin Potok, shqiptarët nuk mund t'i marrin dokumentet në gjuhën e tyre. Dokumentacioni lëshohet vetëm në gjuhën serbe. Madje shqiptarët e këtyre komunave fare nuk mund t'i marrin disa dokumente që u nevojiten.

*Edhe pse ekziston zyra për regjistrim, ne kurrsesi nuk mund ta marrim certifikatën e kurorëzimit, e as vërtetimin për pronësi. Komuna nuk na i jep neve ato. Për shkak se nuk mund ta marrim vërtetimin mbi pronësinë, nuk mund as të bëjmë marrëveshje për shitblerje.*

**B.Z. shqiptar nga fshati Çabër/Čabar**  
Intervistë e FDH-së, 24 janar 2008

Banorët e fshatit Çabër/Čabra kanë vërejtje në punën e zyrës për komunitete, sepse ajo nuk është transparente. Zyrtarët asnjëherë nuk i kanë ftuar për marrëveshje dhe as nuk i kanë informuar për punën e autoriteteve lokale.

*Në këto zyre satelite punojnë shqiptarët, prandaj nuk kemi probleme gjatë komunikimit, por kemi vërejtje në lidhje me punën e zyrës për komunitete, sepse nuk është transparente në punën e saj. Ne nuk e dimë sa të holla nga buxheti komunal janë ndarë për fshatin Çabër. Asnjëherë nuk është organizuar ndonjë tribunë apo ndonjë debat i hapur, ku do të mund t'i parashtronim këto pyetje. Si rezultat i kësaj, ne nuk dimë asgjë për punën e komunës së Zubin Potokut, dhe as për të drejtat dhe detyrimeve që i kemi ndaj saj.*

#### **B.Z shqiptar nga fshati Çabër/Çabar**

Intervistë e FDH-së, 24 janar 2008

Një herë në javë, në këto fshatra vjen mjeku nga Mitrovica/Mitrovica, kurse në rast të problemeve serioze shëndetësore banorët shkojnë në spitalin e Mitrovicës/Mitrovica jugore. Fshatrat Bistricë/Bistrica, Koshtovë/Koštova, Cerajë/Ceraja dhe Çabër/Çabar kanë shkollat fillore, të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës. Shkolla e mesme më e afërt është në Mitrovicën/Mitrovica jugore. Për të shkuar në shkollën e mesme, fëmijët udhëtojnë, marrin banesë me qira ose banojnë te të afërmit e tyre.

Shqiptarët në këto fshatra i marrin faturat për rrymë, por në përgjithësi nuk i paguajnë sepse nuk kanë të holla. Posta vjen përmes zyrës për komunitete. Nuk kanë numra fiks të telefonit. Ka valë të telefonisë mobile Vala 900, por banorët në fshatra nuk mund të blejnë mbushje.

Të gjitha fshatrat e këtij regjioni janë në pozitë shumë të palakmueshme sa i përket informimit. Nuk ka sinjal të televizioneve të Kosovës RTK, KTV i TV21 në veri të Kosovës. Nuk ka as valë të radio stacioneve kosovare. Shqiptarët e këtyre fshatrave, dikur janë informuar përmes RTV Mitrovicës, por në fund të vitit 2007, kjo shtëpi radiotelevizive është mbyllur. Tani mund t'i përcjellin vetëm kanalet serbe. Asnjë gazetë nuk arrin në këto fshatra. Për vendet e lira të punës banorët informohen përmes zyrës për komunitete.

Vetëm një numër i vogël i banorëve të fshatrave Koshtovë/Koštova, Cerajë/Ceraje dhe Bistricë/Bistrica janë të punësuar edhe atë: pesë 5 në zyrën për komunitete në Bistricë/Bistrica, 10 persona punojnë në shkollën fillore në Bistricë/Bistrica, si dhe një i punësuar në ambulancë. Tre persona janë të punësuar në KFOR, si ruajtës të antenës e cila gjendet në fshatin Cerajë/Ceraje. Nuk ka të punësuar në SHPK.

Njëmbëdhjetë banorë të fshatit Çabër/Çabra janë të punësuar në Kuvendin e komunës të Zubin Potokut/Zubin Potok, tre në SHPK, dy në ambulancë dhe një në ujësjellësin regjional që ndodhet në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica.

#### **1.1 Shqiptarët në komunitet Zubin Potok/ Zubin Potok dhe Leposaviq/Leposavić pas shpalljes së pavarësisë**

Pas 17 shkurtit të vitit 2008, zyrtarët e komunës së Zubin Potokut/Zubin Potok dhe Leposaviqit/Leposavić, të punësuar në zyrën për komunitete dhe zyrën për regjistrim civil në fshatin Çabër/Çabra dhe Bistricë/Bistrica, nuk shkojnë në mbledhjet që organizohen në këto kuvende komunale për shkaqe sigurie.

Kuvendi i komunës së Leposaviqit/Leposavić e ka bllokuar buxhetin për komunitetet pakicë në këtë komunë. Meqenëse vula gjendet në komunë, zyrtarët shqiptarë të zyrës për komunitete në Bistricë/Bistrica nuk mund të vërtetojnë asnjë dokument. Këtë tash mund ta bëjnë vetëm në Mitrovicën/Mitrovica e jugut dhe në Prishtinë/Priština.

Situatë e ngjajshme është edhe në Çabër/Çabra.

Pas shpalljes së pavarësisë është vërejtur një koncentrim më i madh i pjesëtarëve të SHPK-së, policisë së UNMIK-ut dhe KFOR-it. Pikërisht për këtë arsye, banorët shqiptarë nuk ankohen në probleme sigurie. Shqiptarët pohojnë se provokohen nga kalimtarët serbë në rrugën magjistrale deri në Mitrovicë/Mitrovica. Serbët e dinë në cilët autobusë udhëtojnë shqiptarët sepse pas shpalljes së pavarësisë, minibusin i cili i transporton shqiptarët e këtyre fshatrave deri në Mitrovicë/Mitrovica ose Prishtinë/Priština e përcjell policia e SHPK-së ose ajo e UNMIK-ut.

*Të gjitha dokumentet tona sikurse edhe vulat janë bllokuar në komunën e Leposaviqit, sikurse edhe buxheti i paraparë për komunitetin pakicë. U jam drejtuar përgjegjësve në UNMIK, por ata nuk reagojnë, me fjalë tjera nuk janë të interesuar të na ndihmojnë.*

#### **H.I. drejtor i zyrës për komunitete në Kuvendin e komunës së Leposaviqit/Leposavić**

Intervistë e FDH-së, 9 prill 2008

## 2. Serbët në fshatin Bajë/Banja deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Baja/Banja është fshat serb në komunën e Skenderajt/Srbica në të cilën jetojnë rreth 200 serbë në 60 amvisëri. Në fshat gjithashtu jetojnë edhe katër familje shqiptare. Serbët e këtij fshati nuk gëzojnë lirinë e lëvizjes. Ata, nuk shkojnë në komunën e Skenderajt/Srbica për shkak se kanë frikë, por të gjitha punët i kryejnë përmes zyrës për komunitete e cila ndodhet në fshat. Për shkak të frikës që është e pranishme këtu, asnjë serb nuk e shfrytëzon transportin publik. Ata të cilët posedojnë automjete, përkundër faktit që kanë regjistrimet «KS» nuk guxojnë të udhëtojnë gjithkund nëpër Kosovë.

Tash, raportet e banorëve të fshatit dhe SHPK-së janë të mira. SHPK-ja komunikon me banorët serb në gjuhën serbe. Edhe dënimet në komunikacion jepen në gjuhën serbe. SHPK-ja ofron siguri për serbët kur shkojnë në gjykatë apo në bankë në Skenderaj/Srbica. Zyrtarët e këtyre institucioneve bisedojnë me serbët në gjuhën serbe.

*Po të kishim siguri, ne do të punonim në institucionet e Kosovës. Unë kam punuar me shqiptarët më parë, pse të mos punoj edhe tani, por nuk mund të lëviz lirisht. Besoj se edhe banorët tjerë të fshatit do të punonin po të kishin lirinë e lëvizjes. Askush nuk guxon të shfrytëzojë transportin publik.*

**R.K serb nga fshati Bajë/Banja**  
Intervistë e FDH-së, 20 janar 2008

*Më parë kishim përvojë të keqe me SHPK-në, veçanërisht para se të hapej stacioni policor në fshatin Suhogërlë, ku tani punon një polic serb. Deri në vitin 2003 në fshat kanë shërbyer policët nga Skenderaj, që të gjithë shqiptarë. Një nga ata është sjellë shumë keq me ne. Ai e dërgoi një të ri në stacionin e policisë vetëm sepse nuk dinte shqip. Më pas këtë polic e kanë larguar.*

**R.K serb nga fshati Bajë/ Banja**  
Intervistë e FDH-së, 20 janar 2008

Në fshat gjendet shkolla e cila është në kompetencë të Qeverisë së Serbisë. Shkolla e mesme ndodhet në fshatin serb fqinj, Suhogërlë/Suvo Grlo. Fshati gjithashtu ka edhe ambulancën serbe. Në rsate kur nevojitet ndihmë urgjente mjekësore, serbët e fshatit

Bajë/Banja udhëtojnë deri në Zubin Potok/Zubin Potok.

Banorët e këtij fshati nuk i marrin faturat nga KEK-u dhe nuk e paguajnë rrymën. Në rast të prishjeve ata i thërrasin elektrikistët serbë të cilët para lufte kanë punuar në EPS për ta zgjidhur problemin.

Serbët nga Baja/Banja informohen përmes programeve të RTS-së dhe RTK-së në gjuhën serbe. Në tabelën e shpalljeve të zyrës për komunitete publikohen disa informata dhe iniciativa të komunës së UNMIK-ut.

### 2.1 Serbët në fshatin Bajë/Banja pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Pozita e komunitetit serb në fshatin Bajë/Banja nuk ka ndryshuar shumë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Serbët vazhdojnë të mos kenë lirinë e plotë të lëvizjes dhe për shkaqe sigurie nuk e shfrytëzojnë transportin publik. Megjithatë, disa serbë shkojnë lirisht në komunën e Skenderajt/Srbica në cilësinë e përfaqësuesve të zyrës për komunitete nga ky fshat. Serbët akoma i kryejnë të gjitha punët e tyre administrative përmes kësaj zyre.

Pas 17 shkurtit 2008, serbët e punësuar në zyrën për komunitete nuk e kanë lëshuar punën, por këtë e kanë bërë dy serbë të cilët kanë punuar në SHPK. Tani në këtë fshat patrollojnë vetëm policët shqiptarë.

*Në zyrën për komunitete punojnë 7 zyrtarë dhe të gjithë janë nga komunitetet pakicë. Ata vazhdojnë të punojnë aty. Nuk ka pasur ndonjë rast që dikush të ketë lëshuar punën pas 17 shkurtit të këtij viti. Shef i zyrës vjen rregullisht në mbledhjet në komunë, madje udhëton me veturën e tij dhe nuk ka asnjë problem. Kur u takuam herën e fundit, ai më la të kuptojë se disa individë, me urdhër të Qeverisë së Serbisë, ushtrojnë presion në të dhe bashkëpunëtorët e tij. Ai më tha se do të vazhdojnë të punojnë për institucionet e Kosovës.*

**F.B. zyrtar në zyrën për kthim në Kuvendin e komunës Skenderaj/Srbica**  
Intervistë e FDH-së, 11prill 2008

*Ne punojmë rregullisht dhe nuk e kemi ndërprerë punën as pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës ... më parë kanë punuar edhe dy pjesëtarë në SHPK,*

më saktë në nën-stacionin e SHPK-së në fshatin fqinj të Suhogërrllës, por ata e kanë lëshuar punën pas 17 shkurtit të vitit 2008, ashtu siç kanë vepruar shumica e bashkëkombësve të tyre nga komuniteti serb ... gjashtë muajt e fundit nuk ka pasur asnjë incident. Megjithatë, te komuniteti serb akoma mbizotëron frika. Edhe më tej, SHPK-ja vazhdon të patrullojë në fshat, por tani në këto patrulla ka vetëm shqiptarë. Askush nga fshati nuk e shfrytëzon transportin publik sepse ka frikë. Të gjitha palët punët që kanë në komunë i kryejnë përmes zyrës tonë. Ne këtu nuk lëshojmë dokumente, por ndërmjetësojmë në nxjerrjen e tyre nga komuna e Skenderajt.

**Lj.J. zyrtar i zyrës për komunitete në fshatin Bajë/  
Banja**

Intervistë e FDH-së, 11 prill 2008

### **3. Romët dhe Ashkalinjtë në Mitrovicë/Mitrovica**

Rreth 65 familje të romëve dhe ashkalinjëve të kthyer jetojnë në lagjen rome në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Para se të kthehen ata kanë jetuar nëpër kampe në Mitrovicën/Mitrovica e veriut.

Asnjë nga romët apo ashkalinjtë në Mitrovicën/Mitrovica jugore nuk është i punësuar në institucionet e Kosovës. Dhjetë prej tyre punojnë në fabrikën e brumërave *Zhitopromet*. Para lufte ata kanë punuar në ndërmarrjen publike për pastrimin e qytetit *Higjiena*, por sot asnjë nga romët dhe ashkalinjtë nuk është kthyer në punë. Romët dhe ashkalinjtë e kësaj lagje nuk kanë marrë mjete për hapjen e fabrikës për përpunimin e drurit, ku është paraparë të punojnë 40 punëtorë. Gjithashtu kanë provuar ta iniciojnë projektin për një fermë të vogël bagëtie, megjithatë, as për këtë iniciativë nuk u janë ndarë mjete. Atyre nuk u janë dhënë sqarime pse nuk po financohet asnjë nga këto projekte.

*Na kanë ndërtuar shtëpi ku nuk ka kushte për jetesë, por nuk kanë menduar për punësimin e të kthyerve. Nëse vazhdon kjo gjendje, të gjithë do ta lëshojmë lagjen e romëve. Na kanë premtuar fusha dhe kodra, sepse kanë pasur për qëllim vetëm të na kthejnë. Në deklaratën për kthim thuhet se një vit do të marrim ndihmë humanitare, por e kemi marrë vetëm për tre muajt. Gjithashtu, thuhet se nuk do t'i paguajmë shpenzimet komunale derisa të punësohet ndonjë anëtar i familjes, por faturat vazhdojnë të na vijnë. Të gjitha familjet kanë aplikuar*

*që të mos e paguajnë rrymën sepse janë raste sociale. Në fatura emrat dhe mbiemrat janë të shkruara në gjuhën shqipe. Restriktionet janë të përditshme, dhe pjesën më të madhe të kohës nuk ka rrymë. Shikuar në përgjithësi, më mirë i kishim punët në kampet e Mitrovicës veriore.*

**Q. G. rom nga Mitrovica/Mitrovica jugore**

Intervistë e FDH-së, 12 shkurt 2008

Romët dhe ashkalinjtë kanë lirinë e lëvizjes. Në komunikim me zyrtarët e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve ata shprehen në gjuhën shqipe. Këto komunitete i kanë përfaqësuesit e tyre në komunë, por shumica e romëve dhe ashkalinjëve mendojnë se ata nuk i përfaqësojnë interesat e tyre ashtu siç duhet.

43 fëmijë romë dhe ashkalinjë shkojnë në shkollat serbe në Mitrovicën/Mitrovica e veriut. Për ata është organizuar transporti me kombi-bus, por prej mesit të shkurtit kombi-busi më nuk qarkullon, sepse është prishur. Kishte një iniciativë nga ana e UNICEF-it dhe drejtorisë komunale për arsim të komunës së Mitrovicës/Mitrovica që fëmijët rom dhe ashkali të shkojnë në shkollat e Mitrovicës/Mitrovica së jugut, por kjo iniciativë dështoi.

*Pas kthimit tonë në lagje, në gusht të vitit 2007, zyrtarët e komunës na kanë thënë se fëmijët do t'i marrin mjetet shkollore dhe librat pa pagesë, nëpërmes UNICEF-it, nëse i regjistrojmë fëmijët në shkollat e pjesës jugore të Mitrovicës, ku do të mësonin në gjuhën shqipe. Ne pranuan. U përgatit regjistri, por nuk kemi marrë kurrfarë ndihme, prandaj fëmijët kanë vazhduar të shkojnë në shkollat në veri. Në fund të shtatorit të vitit 2007, na kanë vizituar përfaqësuesit e UNICEF-it dhe na kanë pyetur nëse fëmijët kanë filluar të shkojnë në shkollat e pjesës jugore të Mitrovicës, sepse ata e kishin dërguar një pjesë të ndihmës. Nuk kemi marrë akoma përgjigje se si ka ndodhur kjo dredhi.*

**Q.G. rom nga Mitrovica/Mitrovica jugore**

Intervistë e FDH-së, 12 shkurt 2008

Në lagjen rome ekziston ambulanca ku punojnë tre teknikë medicinal shqiptarë. Dy herë në javë një mjek shqiptar vjen në ambulancë. Romët dhe ashkalinjtë me teknikët dhe mjekun flasin në gjuhën shqipe. Orari i punës së ambulancës është prej 7.00 deri në 14.00, derisa në fundjavë është e mbyllur.

Romët dhe ashkalinjtë faturat i marrin në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Megjithatë, rrymën nuk e paguan askush sepse nuk kanë të holla.

Informohen përmes programit Radio KISS, i cili një herë në javë transmeton program në gjuhën rome. Programi zgjat 30 minuta. TV Most, televizion në gjuhën serbe, transmeton program në gjuhën rome një herë në javë në kohëzgjatje prej 90 minuta. Informatat mbi punën e komunës, institucionet dhe organeve komunale në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica romët dhe ashkalinjtë nuk i marrin nga këto media, sepse ato janë themeluar në pjesën veriore të qytetit, dhe përpos programit në gjuhën rome transmetojnë edhe programe edhe në gjuhën serbe.

#### 4. Boshnjakët në Mitrovicën/Mitrovica jugore dhe veriore

Para fillimit të konfliktit të armatosur, në Mitrovicë/Mitrovica kanë jetuar rreth 7500 pjesëtarë të komunitetit boshnjak. Pas lufte, në të dy pjesët e qytetit, jetojnë rreth 1500 boshnjakë. Prej këtij numri, 900 jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, në lagjen e boshnjakëve. Megjithatë, boshnjakët po shpërngulen vazhdimisht, sepse në të dy pjesët e qytetit nuk kanë kushte për jetesë.

Boshnjakët në pjesën jugore dhe veriore të Mitrovicës/Mitrovica, gëzojnë lirinë e lëvizjes. Ata kanë qasje të lirë në të gjitha institucionet. Raportet me SHPK-në janë të mira. Ka incidente sporadike, të cilat e rrezikojnë sigurinë e boshnjakëve. Kjo në radhë të parë ndodh në Mitrovicën/Mitrovica veriore, ku serbët janë shumicë. Më 17 nëntor 2007, gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare të Kosovës, serbët lokal nuk u kanë mundësuar boshnjakëve të fshatrave Revatskë/Rvatska dhe Kalin/Kaljin dhe atyre të lagjes së boshnjakëve në Mitrovicën veriore të shkojnë në vendvotime. Këta boshnjakë kanë votuar në vendvotime të improvizuara, të cilat i ka mundësuar OSBE-ja.

*Kërcënimet vazhdojnë edhe sot e kësaj dite për shkak se po ndërtohet xhamia në fshatin Rvatskë, të cilën boshnjakët e ruajnë ditë e natë sepse kanë marrë kërcënime nga serbët lokal se do ta djegin dhe rrëzojnë.*

**N. U. boshnjak nga Mitrovica/Mitrovica**  
Intervistë e FDH-së, 24 janar 2008

Për sa i përket respektimit të ligjit mbi përdorimin e gjuhëve në institucione, gjendja është shumë më e mirë në pjesën veriore të qytetit sesa në atë jugore. Në institucionet e UNMIK-ut, që funksionojnë si komunë në pjesën veriore të qytetit, boshnjakët

i kryejnë të gjitha punët në gjuhën e tyre amtare. Dokumentacionin që e marrin nga këto institucione është në gjuhën boshnjake. Informatat në tabelat për shpallje janë gjithashtu në gjuhën boshnjake.

Sa i përket pjesës jugore të qytetit, të gjitha informatat në komunë janë vetëm në gjuhën shqipe. Nëse boshnjakët u drejtohen zyrtarëve shqiptarë në gjuhën boshnjake, atëherë përgjigjen do ta marrin po në atë gjuhë. Në rast se zyrtarët nuk e flasin gjuhën serbe/boshnjake, sipas nevojës thërritet përkthyesi zyrtar. Përndryshe, shumica e boshnjakëve në Mitrovicë e njohin gjuhën shqipe prandaj shumë rrallë ka nevojë për përkthyes. Kur boshnjakët i drejtohen komunës me shkrim në gjuhën boshnjake, përgjigjen e marrin në gjuhën shqipe. Me atë rast, edhe emrat e tyre në dokumentin e dërguar janë të shkruara sipas rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe. Faturat të cilat u dorëzohen boshnjakëve, nga ndërmarrjet publike, gjithashtu janë vetëm në gjuhën shqipe. Emrat e boshnjakëve në ato fatura janë të shkruar sipas rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe. Sa i përket institucioneve tjera në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica, komunikimi më i mirë është me bashkësinë islame. Të gjitha informatat në këtë institucion janë të shkruara edhe në gjuhën boshnjake. Dokumentacionin në formë të shkruar të cilin boshnjakët e marrin nga bashkësia islame po ashtu është në gjuhën boshnjake. Teksti është i shkruar në përputhje me rregullat drejtshkrimore dhe gramatikore të gjuhës boshnjake.

Komuniteti boshnjak në Mitrovicë/Mitrovica nuk është i kënaqur me punën e përfaqësuesve të pakicave në nivel komunal dhe qendror.

*Kur bëhet fjalë për përfaqësuesit e komuniteteve pakicë në komunën e Mitrovicës, mendoj se ata nuk e kryejnë punën në përputhje me detyrimet të cilat i kanë marrë. Për këtë arsye, në lagjen e boshnjakëve, së bashku me komunitetet tjera, kemi formuar komitetin për komunitete, autoriteti i së cilit është më i madh se zyra për komunitete, e cila e mban monopolin e konkurseve, d.m.th të vendeve të lira të punës në komunë, sepse gjithmonë ato përfundojnë në sirtarët e tyre. Ne nuk kemi dijeni se komuna ka shpallur vende të lira të punës.*

**N. U. boshnjak nga Mitrovica/Mitrovica**  
Intervistë e FDH-së, 24 janar 2008

Boshnjakët në Mitrovicë/Mitrovica janë informuar përmes RTV Mitrovica. Në këtë medium është transmetuar program në gjuhën boshnjake, në kohëzgjatje prej 60 minuta. Me këtë rast, boshnjakët janë infor-

muar edhe për vendet e lira të punës dhe aktivitetet e autoriteteve lokale dhe qendrore. Ky televizion është mbyllur në fund të vitit 2007. Qytetarët tani pothuajse nuk kanë asnjë informatë për aktivitetet e komunës. Boshnjakët në Mitrovicë/Mitrovica aktualisht mund të përcjellin vetëm programet e RTS-së dhe TV *Most* që transmetojnë programe në gjuhën serbe.

Vetëm 16 boshnjakë janë të punësuar në komunë, e cila ndodhet në pjesën jugore të qytetit, derisa pesë prej tyre punojnë në administratën e UNMIK-ut, e cila gjendet në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica. Nuk ka të dhëna për numrin e saktë të boshnjakëve të punësuar në ndërmarrjet publike, meqenëse udhëheqja e këtyre institucioneve ka refuzuar që përfaqësuesve të boshnjakëve t'ua tregojë numrin e të punësuarve nga radhët e komuniteteve pakicë.

Ka raste kur disa shqiptarë paraqiten si boshnjakë për t'i zënë vendet e punës ku do të duhej të punësohen boshnjakët.

*Zyrtarisht thuhet se rreth 100 boshnjakë janë të punësuar në SHPK, por ne dyshojmë se 40 prej tyre paraqiten rrejtshëm si boshnjakë ... dua të theksoj se shqiptarët vijnë te unë dhe kërkojnë t'u lëshoj, vërtetoh apo nënshkruaj vërtetimin se janë pjesëtarë të komunitetit boshnjak, sepse më lehtë „e gjejnë veten“ në vendet evropiane. Dallaveret e tilla i hedhim poshtë në mënyrë kategorike.*

**N. U. boshnjak nga Mitrovica/Mitrovica**  
Intervistë e FDH-së, 24 janar 2008

## Regjioni i Pejës/Peć

### 1. Serbët në fshatrat Bellopojë/Belo Polje dhe Dërsnik/Drnsnik deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Bellopoja/Belo Polje është fshat serb që gjendet në komunën e Pejës/Peć, derisa Dërsniku /Drnsnik është fshat serb në komunën e Klinës/Klina. Në Bellopojë/Belo Polje jetojnë 50 banorë, kurse në Dërsnik/Drnsnik 30 të kthyer, të cilët janë të gjithë të moshës madhore. Serbët në këto fshatra në përgjithësi gëzojnë lirinë e lëvizjes. Megjithatë, janë të mendimit se Qeveria e Kosovës akoma nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat që t'i mundësojë kësaj bashkësie etnike jetë normale në Kosovë.

Banorët e Bellopojës/Belo Polje pohojnë se janë plotësisht të lirë. Nga ana tjetër, serbët e fshatit Dërsnik/Drnsnik, edhe pse lëvizin lirisht, mendojnë se akoma duhet të jenë të vëmendshëm. Ata i punojnë edhe arat të cilat gjenden larg fshatit, por këtë e bëjnë me një ndjenjë të madhe pasigurie. Ka pasur raste kur edhe pronarët e disa objekteve hoteliere në Klinë/Klina kanë kërkuar nga serbët e Dërsnikut/Drnsnik që të mos shkojnë më në kafenetë e tyre, gjë që i ka bërë ata të ndihen edhe më të pasigurt.

Qytetarët e komunitetit serb të regjionit të Pejës/Peć, zakonisht, nuk e përdorin transportin publik për të udhëtuar. Ata udhëtojnë me veturat e tyre, që kanë regjistrimet «KS», me autobusë, pronarët e të cilëve janë serbë, ose me taksitë e shoferëve e serbë.

Banorët serbë të këtyre fshatrave janë të kënaqur me bashkëpunimin që kanë me SHPK-në. Policët rregullisht i vizitojnë fshatrat dhe me banorët komunikojnë në gjuhën serbe. Madje edhe pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse së Kosovës (TMK) u kanë ndihmuar serbëve të Bellopojës/ Belo Polje në rregullimin e kopshteve.

Banorët e Bellopojës/Belo Polje dhe Dërsnikut/Drnsnik kanë qasje të lirë në institucione e Kosovës, komuna dhe gjykata, ku të gjitha punët i kryejnë duke folur në gjuhën e tyre dhe pajisen me dokumentet përkatëse. Nëse ndonjë nga zyrtarët nuk flet gjuhën serbe, atëherë thërrasin përkthyesin zyrtar, i cili është i punësuar në këto institucione. Disa serbë të fshatit Dërsnik /Drnsnik janë ankuar për një zyrtar shqiptar në komunën e Klinës/Klina, i cili nuk e flet gjuhën serbe dhe nuk e thërret përkthyesin zyrtar në rast nevojë, prandaj serbët nuk mund t'i kryejnë punët për të cilat kanë shkuar atje.

*Ne, të kthyerit në fshatin Bellopojë, kemi qasje të lirë në të gjitha institucionet pa kurrfarë problemi. Gjithkund lëvizim lirisht. Tani situata është 100 për qind më e mirë. Emrat personal në dokumentet të cilat i marrim nga komuna janë të shkruara drejt. Vendimin për pension e kam marrë në gjuhën serbe.*

**B. P. serb nga Bellopoja/Belo Polje**  
Intervistë e FDH-së, 1 shkurt 2008

*Ka edhe raste të izoluar që nuk mund të përgjithësohen. Në zyrën komunal për kthim ku punon një serb, punon edhe një shqiptar, i cili nuk e flet ose nuk do të flas në gjuhën serbe. Nëse zyrtari serb nuk ndodhet aty,*

*serbët nuk mund të kryejnë punë në komunë. Edhe pse komuna ka përkthyes, ky person nuk e thërret atë që të na ndihmojë në komunikim.*

**M. R. serb nga fshati Dërsnik/Drnsnik**  
Intervistë e FDH-së, 15 shkurt 2008

Në këto fshatra nuk është ndërtuar shkolla. Po të kthehen fëmijët e moshës shkollore, nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme do të duhej që prej Bellopojës/Belo Polje të shkojnë në Gorazhdec/ Goraždevac. Një degë e gjimnazit të Gorazhdecit/Goraždevac ndodhet në fshatin Osojan/Osojane, në komunën e Istogut/Istok. Nxënësit e shollës fillore nga Dërsniku/Drnsnik do të duhej të shkonin në shkollën e fshatit Vide, kurse ata të shkollës së mesme në fshatin Gorazhdec/ Goraždevac ose Osojan/Osojane.

Në rast nevojë shëndetësore, serbët e këtyre dy fshatrave lirisht shkojnë në shtëpitë e shëndetit në Pejë/Peć ose në Klinë/Klina. Megjithatë, serbët më së shpeshti shkojnë në ambulancën serbe në Gorazhdec/ Goraždevac, e cila është në kompetencë të Qeverisë së Serbisë.

Shumica dërmuese e serbëve të këtyre fshatrave nuk i merr faturat për energjinë elektrike të shpenzuar. Ata serbë të cilët i marrin thonë se faturat janë të shkruara në gjuhën serbe dhe shqipe, dhe emrat e tyre janë shkruar në përputhje me rregullat drejtshkrimore dhe gramatikore të gjuhës serbe.

Faturat për ujin e shpenzuar, që për serbët e fshatit Dërsnik/Drnsnik vijnë nga ndërmarrja publike *Hidrodrini*, janë në gjuhën shqipe. Emrat e tyre janë shkruar në përputhje me rregullat e gjuhës shqipe.

Serbët e Bellopojës/Belo Polje në radhë të parë kanë vërejtje në punën e pjesëtarëve të fshatit në qendrën koordinuese të Qeverisë së Serbisë për Kosovë dhe Metohi.

*Kemi shumë vërejtje në punën e përfaqësuesit tonë në qendrën koordinuese. Ai nuk punon për ne, ai vetëm vjedh. Gjithë ndihma që vjen nga Serbia përfundon në xhepin e tij. Ai nuk na i ka dhënë as drunjtë të cilat na janë ndarë si ndihmë humanitare.*

**D. M. serb nga fshati Bellopojë/Belo Polje**  
Intervistë e FDH-së, 15 shkurt 2008

Banorët e këtyre fshatrave informohen përmes programeve të RTK-së në gjuhën serbe, RTS-së dhe

radiostacionit Hyatt. Serbët janë të mendimit se emisioni i RTK-së në gjuhën serbe “*Nedeljni kolaž*”, si dhe emisioni i lajmeve pesëmbëdhjetë minutash, nuk i plotësojnë nevojat e komunitetit serb për informim. Serbët gjithashtu marrin informata edhe përmes tabelave për shpallje në Bellopojë/Belo Polje, Dërsnik/Drnsnik, si dhe tabelën për shpallje në Kuvendin e komunës së Klinës/Klina dhe në zyrën për komunitete në Gorazhdec/Goraždevac. Serbët nga këto dy fshatra theksojnë se kështu nuk mund të ketë informim kualitativ.

*Para komunës së Klinës gjendet tabela për shpallje me informata në gjuhën serbe, por këto informata janë të pamjaftueshme, sepse mua për shembull, më intereson procesi i privatizimit për të cilin nuk di asgjë. Kam kërkuar informata në zyrën për komunitete mbi këtë problematikë, por kam marrë përgjigje se ajo nuk është puna e tyre.*

**M. R. serb nga fshati Dërsnik/Drnsnik**  
Intervistë e FDH-së, 15 shkurt 2008

Një banor i Bellopojës/Belo Polja është i punësuar në SHPK, kurse dy fshatarë të Drësnikut/Drnsnik punojnë në komunën e Klinës/Klina. Asnjë serb nuk punon në TMK. Pothuajse të gjithë serbët merren me bujqësi dhe të gjithë janë raste sociale.

### **1.1 Serbët në fshatrat Bellopojë/Belo Polje, Dërsnik/Drnsnik dhe Vide/Vidanje pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës**

Pozita e komunitetit serb në fshatin Bellopojë nuk ka ndryshuar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Serbët e këtij fshati pohojnë se akoma kanë lirinë e plotë të lëvizjes. Ata lirisht shkojnë në Pejë/Peć, ku kanë qasje në të gjitha institucionet komunale. Nga ana tjetër, banorët e Vides/Vidanja mendojnë se gjendja e tyre është keqësuar pas 17 shkurtit të vitit 2008 dhe se nuk kanë lirinë e lëvizjes.

SHPK-ja dhe KFOR-i vazhdojnë t'i vizitojnë rregullisht këto fshatra.

Sa u përket të punësuarve serbë në institucionet e kuvendit komunal të Pejës/Peć dhe Klinës/Klina, asnjë nga ata nuk e ka lëshuar vendin e tij të punës pas 17 shkurtit. Përndryshe, një banor i fshatit Bellopojë/Belopolje vazhdon të punojë në SHPK.

*Situata në Bellopojë është e njëjtë si para 17 shkurtit të vitit 2008. Liria e lëvizjes është në të njëjtin nivel. Banorët e fshatit shkojnë lirisht në komunë dhe gjykatë kur kanë punë. Të gjithë banorët e Bellopojës shëtisin lirisht nëpër Pejë. SHPK-ja na viziton si më parë. Në SHPK punon edhe një banor i fshatit. KFOR-i gjithashtu është shpesh në fshat.*

**B. P. serb nga Bellopoja/Belo Polje**

Intervistë e FDH-së, 9 prill 2008

*Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, gjendja e serbëve që jetojnë në komunën e Klinës ka ndryshuar në kuptim të ndjenjës së pasigurisë dhe të ardhmes së pasigurt në këtë komunë. Pas 17 shkurtit të vitit 2008, përpos pohimeve të një serbi të fshatit Vidanj se ka parë persona të maskuar në oborrin e shtëpisë së tij, nuk ka pasur incidente, por jam i mendimit se këtë ngjarje nuk duhet marrë seriozisht, sepse ai person vazhdimisht e ndërron deklaratën e tij në lidhje me këtë rast.*

**V. P. Serb nga fshati Vide/Vidanje**

Intervistë e FDH-së, 10 prill 2008.

## **2. Boshnjakët në fshatin Dobrushë/ Dobruša**

Fshati Dobrushë/Dobruša në të cilin jetojnë vetëm boshnjakët gjendet në komunën e Istogut/Istok. Këta boshnjakë kanë lirinë e plotë të lëvizjes dhe qasje të lirë në të gjitha institucionet kosovare. Ata janë të integruar plotësisht në shoqërinë kosovare.

*Për mua është me të vërtetë e pakëndshme kur dikush më quan pakicë, sepse unë ndihem si kosovar. Mendoj se ka mjaft njerëz të gatshëm për t'u integruar më mirë në shoqërinë kosovare.*

**S. S. boshnjak nga fshati Dobrushë/Dobruša**

Intervistë e FDH-së, 15 shkurt 2008

Të gjitha punët në institucionet kosovare, boshnjakët i kryejnë në gjuhën e tyre amtare. Nëse ndonjë nga zyrtarët komunal nuk e kupton gjuhën boshnjake, atëherë thërrasin përkthyesin zyrtar. Të gjithë dokumentacionin nga komuna e marrin në gjuhën e tyre amtare. Emrat e boshnjakëve në këto dokumente janë të shkruara në përputhje me drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës shqipe. Përndryshe, boshnjakët janë të punësuar në komunën e Istogut/Istok sikurse edhe në gjykatën komunale.

*Unë ju drejtova Drejtorisë për shëndetësi të komunës së Istogut me lutje për punësim, në përputhje ligjet në fuqi. Drejtorja për shëndetësi më mundësoi intervistën dhe testimin për vendin e punës, në gjuhën boshnjake. Pas kësaj e fitova punën. Tash jam teknik mjekësor në spitalin e Istogut.*

**S.S. boshnjak nga fshati Dobrushë/Dobruša**

Intervistë e FDH-së, 15 shkurt 2008

Boshnjakët nga Dobrusha/Dobruša kërkojnë përkudjesje mjekësore në Shtëpinë e shëndetit në Istog/Istok. Me mjekët komunikojnë në gjuhën e vet. Në këtë Shtëpi të shëndetit punon edhe një boshnjak, i cili në komunikimin e përditshëm me kolegët shqiptarë flet në gjuhën amtare. Vendimi i punës është përgatitur në gjuhën shqipe dhe boshnjake

Në Dobrushë/Dobrusha ndodhet shkolla fillore në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën boshnjake. Shkolla e mesme teknike, ajo mjekësore dhe gjimnazi ku mësimi zhvillohet në gjuhën boshnjake, ndodhen në Pejë. Në të gjitha këto shkolla janë të punësuar boshnjakët. Ekziston edhe fakulteti privat ku studiojnë boshnjakët dhe i cili zbaton në tërësi dispozitat e ligjit mbi përdorimin e gjuhëve. I tillë është fakulteti AAB në Prishtinë/Priştina. Të gjitha dokumentet, lajmërimet, kontratat, ligjëratat dhe literatura janë në gjuhën boshnjake.

Faturat për shfrytëzimin e energjisë elektrike të shpenzuar, rregullisht u dërgohen banorëve të këtij fshati dhe janë të përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe/boshnjake. Emrat gramatikiqsh janë të shkruara në mënyrë të rregullt.

Boshnjakët në këtë fshat informohen kryesisht përmes programit të RTK-së në gjuhën boshnjake. Megjithatë boshnjakët janë të mendimit se kjo nuk i plotëson nevojat e tyre për informim. Në fshat gjendet edhe tabela për shpallje, por këtu nuk ka informata të mjaftueshme të cilat do të lajmëronin për ndonjë aktivitet në komunën e Istogut/Istok dhe, në përgjithësi, në gjithë regjionin e Pejës.

Tre boshnjakë nga fshati Dobrushë/Dobruša janë të punësuar në SHPK, gjashtë në komunën e Istogut/Istok dhe një në Shtëpinë e shëndetit në Istog/Istok.

# Qëndrimet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës nga radhët e komuniteteve pakicë

## 1. Deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës

Deputetët serbë janë të mendimit se ligji mbi përdorimin e gjuhëve dhe ligji kundër diskriminimit janë ligje të mira, por ato nuk zbatohen plotësisht. Ata pohojnë se deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës janë të diskriminuar, sepse dokumentacioni që u dorëzohet në gjuhën serbe nuk është në alfabetin çirilicë por në atë latin. Me tej, thonë ata, sipas rregullores së Qeverisë për punësim, 22.4 për qind nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet publike duhet të jenë pjesëtarë të pakicave, që e shprehur në numra d.m.th 60.000 të punësuar. Deputetët serbë mendojnë se në realitet numri i të punësuarve është shumë i ulët.

Ata janë të mendimit se, në përgjithësi, serbët nuk e gëzojnë lirinë e lëvizjes, edhe pse shumica e 120.000 serbëve që jetojnë në Kosovë dëshirojnë të integrohen në shoqërinë kosovare.

*Çka mund të thuhet për sigurinë kur jemi në situatë ku fshatari serb e punon arën derisa polici e ruan me pushkë.*

**M. Š. serb, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 25 janar 2008

Disa deputetë serbë nuk kanë njohuri për punën e komunave në Kosovë. Familjet e tyre akoma ndodhen në serbi.

Në rast të problemeve shëndetësore, deputetët serbë kërkojnë ndihmën e mjekëve serbë të cilët punojnë në ambulancat që janë në kompetencë të Qeverisë së Serbisë. Arsyeja për këtë është se nuk kanë besim te mjekët shqiptarë. Gjithashtu, ata mjekohen në ambulancat serbe sepse kanë sigurimin shëndetësor të Serbisë.

*Ndoshta pas 10 vitesh do të mund të mjekohem në Prishtinë. Nuk dua që këtë problem ta politizoj. Kjo ka të bëjë vetëm në besimin te mjeku.*

**M. Š. serb, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 25 janar 2008

Deputetët serbë në radhë të parë informohen nga RTS-ja por edhe nga programi i RTK-së në gjuhën serbe, interneti dhe shtypi ditor që vjen nga Serbia.

Ata nuk janë të kënaqur me shërbimet e ndërmarrjeve publike. Në radhë të parë nuk janë të kënaqur me punën e PTK-së, sepse kjo kompani akoma nuk e ka vendosur rrjetin e telefonisë fikse në mes të Prishtinës/Priştina dhe Mitrovicës/Mitrovica. Gjithashtu, *Kosovatransi* nuk ka vendosur linja të qarkullimit në Kosovën veriore.

*Kjo situatë na largon nga njëri tjetri. Qytetarët nuk janë të bindur se ekzistojnë parakushte për jetë normale dhe të sigurt. Shumica, d.m.th shqiptarët, duhet t'i bindin bashkëqytetarët e tyre serbë se gjendja do të përmirësohet për të mirë. Qeveria e Kosovës duhet t'i krijojë të gjitha kushtet për serbët, e kjo do të thotë të sigurojë shkollim për serbët në gjuhën e tyre amtare, vende të punës etj. Në të kundërtën do të kemi asimilim.*

**M. Š. serb, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 25. janar 2008

## 2. Deputetët turq në Kuvendin e Kosovës

Deputetët turq pohojnë se pjesëtarët e kësaj bashkësie etnike kanë lirinë absolute të lëvizjes, janë plotësisht të integruar në shoqërinë kosovare dhe kanë qasje në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet publike. Arsyeja kryesore e integrimit të suksesshëm të tyre është fakti se pothuajse të gjithë turqit flasin shqip, por edhe një pjesë e mirë e shqiptarëve e një gjuhën turke. Megjithatë, deputetët turq nuk janë të kënaqur me zbatimin e ligjit mbi përdorimin e gjuhëve në Kuvendin e Kosovës, e as në komunat ku përpos gjuhës shqipe dhe asaj serbe edhe gjuha turke është shpallur gjuhë zyrtare, siç është rasti në Prizren/Prizren dhe Gjiilan/Gnjilane. Gjatë mbledhjeve të Kuvendit të Kosovës deputetët turq nuk mund ta përcjellin debatin në gjuhën e vet amtare, sepse përkthimi është siguruar vetëm në gjuhën shqipe dhe serbe. Emrat e deputetëve serbë në kartelat identifikuese të komunës janë shkruar në përputhje me rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe. Deputetët turq pohojnë se nuk ka përkthyes për gjuhën turke as në Kuvendin e Kosovës e as në ministritë e Qeverisë së Kosovës.

Edhe pse Prizreni/Prizren është shembull i komunës ku udhëheqësia komunale përpiqet të zbatojë

të gjitha dispozitat e ligjit mbi përdorimin e gjuhës, kurse gjuha turke ka marrë statusin e gjuhës së tretë zyrtare, ky ligj akoma nuk zbatohet në tërësi. Logoja e komunës akoma nuk është shkruar në gjuhën turke. Dokumentacioni i komunës nuk është përkthyer plotësisht në gjuhën turke. Gjatë kryerjes së punëve në komunë, turqit komunikojnë me zyrtarët komunal kryesisht në gjuhën shqipe. Disa deputetë të Kuvendit të Kosovës i janë drejtuar me shkrim kuvendit komunal në Prizren/Prizren në gjuhën turke kurse përgjigjen e kanë marrë në gjuhën shqipe. Të gjithë deputetët turq pajtohen se është e vështirë të gjenden përkthyes të mirë, prandaj është e pamundur të pritet përkthimi i gjithë dokumentacionit të komunës në gjuhën turke, brenda një afati të arsyeshëm..

*Unë jam duke përgatitur një raport në lidhje me zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve. Vërejtjen më të madhe e kam për Komisionin për gjuhët, i cili është themeluar në bazë të këtij ligji.. Komisioni fare nuk e bën punën e vet dhe nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të mundësuar implementimin e këtij ligji.*

**E.K. turk, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 25 janar 2008

*Unë i jam drejtuar personalisht komunës së Prizrenit, me rastin e një projekti për komunitetin turk. Gjithë dokumentacionin e kam dorëzuar në turqisht. Përgjigjen nga komuna e kam marrë në gjuhën shqipe*

**M.S. turke, deputete në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 25 janar 2008

Në Shtëpinë e shëndetit në Prizren/Prizren pothuajse të gjithë të punësuarit shqiptarë e flasin edhe gjuhën turke. Në komunikim me pacientët e përdorin edhe gjuhën turke.

Turqit në Prizren/Prizren mund të shkollohen në gjuhën e tyre amtare në shkollat fillore dhe të mesme si dhe në Fakultetin e Mësuesisë, që është degë e Universitetit të Prishtinës. Gjithashtu, turqit kanë mundësi që në gjuhën e tyre t'i ndjekin studimet në Degën për gjuhë turke dhe orientalistikë në Universitetin e Prishtinës/Priština. Megjithatë, nxënësit turq të shkollave fillore akoma nuk i kanë librat për të gjitha lëndët, përderisa nuk është përgatitur asnjë libër për lëndët e shkollave të mesme. Librezat e nxënësve dhe indekset janë në gjuhën shqipe.

Ndërmarrjet publike në regjionin e Prizrenit/Prizren nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat për zbatimin e

plotë të ligjit për përdorimin e gjuhëve. Asnjë ndërmarrje nuk i përgatit faturat në gjuhën turke. KEK-u dhe PTK-ja, faturat i përgatisin vetëm në gjuhën shqipe dhe serbe. Ndërmarrjet tjera publike në regjionin e Prizrenit/ Prizren, siç është ujësjellësi regjional *Hidroregjioni jugor*, ose kompania e cila merret me higjienën e qytetit, *Eko regjion*, faturat i përgatit vetëm në gjuhën shqipe.

Deputetët turq informohen përmes programeve të RTK-së në gjuhën shqipe dhe turke, radio Blue Sky-it dhe nga shtypi ditor. Informohen gjithashtu edhe përmes internetit dhe javores *Yeni Donem*, i cili botohet në gjuhën turke. Në RTK, Radio Blue Sky dhe revistën *Yeni Donem* nuk ka shpallje të konkurseve për vende të punës.

Deputetet turq besojnë se pakicat nuk mund të punësohen në supermarketët e mëdhenj, siç është *Benaf-i* dhe *Albi*, nëse nuk e dinë gjuhën shqipe.

### **3. Deputetët boshnjakë në Kuvendin e Kosovës**

Deputetët e këtij komuniteti mendojnë se ligji mbi përdorimin e gjuhëve më së shumti zbatohet në institucionet qendrore të Kosovës, në Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës. Në këto institucione gjithë dokumentacioni është në gjuhën shqipe, angleze, serbe/ boshnjake dhe përherë sigurohet përkthim simultan në mbledhjet dhe sesionet e komunës.

Megjithatë, ligji mbi përdorimin e gjuhëve dhe ligji kundër diskriminimit nuk respektohen plotësisht. Të drejtat e njeriut vazhdojnë të shkelen. Asnjë zëvendësministër nuk është nga radhët e bashkësive pakicë. Pjesëtarët e pakicave nuk janë as drejtorë, e as zëvendës drejtorë në shkollat fillore dhe të mesme që janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës.

Të gjitha institucionet e Kosovës janë të hapura për boshnjakët. Ata, në përgjithësi, nuk kanë vërejtje në profesionalizmin dhe sinqeritetin e zyrtarëve të këtyre institucioneve. Megjithatë, problemet kryesisht paraqiten në shtëpitë e shëndetit. Mjekët e vjetër flasin gjuhën serbe/boshnjake dhe në këtë gjuhë komunikojnë me pacientët boshnjak dhe diagnozat i shkruajnë në gjuhën serbe dhe boshnjake. Për dallim prej tyre, mjekët e rinj diagnozat i shkruajnë vetëm në gjuhën shqipe. Ka pasur raste kur mjekët shqiptarë

nuk kanë treguar vullnet për të biseduar në gjuhën boshnjake. Sipas pohimeve të disa boshnjakëve të punësuar, në shtëpitë e shëndetit ka diskriminim.

*Unë kam shkuar në spital në Prishtinë te një mjek i mirë shqiptar, të cilin e njoh personalisht. Ai din serbisht dhe me mua komunikon në gjuhën serbe, por paramendoni çka më tha: "tash unë po ju flas në gjuhën tuaj, kur të vini herën tjetër ju duhet të më drejtoheni në gjuhën time". Kjo është përvoja ime personale.*

**Xh. M. boshnjak, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 25 janar 2008

*Unë e njoh një mjek shumë të mirë boshnjak, S. H. i cili për momentin është në specializim, në qendrën klinike universitare në Prishtinë. Ai ishte shpallur student i mirë i gjeneratës në Fakultetin e Mjekësisë. Megjithatë, ai nuk trajtohet njëjtë si specialistët tjerë. Atij i kërkohet që t'i shkruajë anamnezat dhe fletë lëshimet në gjuhën shqipe. Meqenëse nuk e flet gjuhën shqipe, nuk po i mundësohet që të kujdeset për të gjithë pacientët. Ai ka vetëm një numër të vogël të pacientësh, prandaj nuk mund të bëhet specialist i mirë.*

**Xh. M. boshnjak, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë FDH-së, 25 janar 2008

Akoma nuk janë përkthyer librat për disa nga lëndët në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën boshnjake. Aktualisht nuk ka asnjë libër për shkollat e mesme në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën boshnjake. Mbledhjet e këshillave mësimore mbahen në gjuhën shqipe, pa u siguruar përkthimi. Të gjitha informatat në shkolla, sikurse edhe dokumentacioni i shkollës, librezat e nxënësve dhe indekset, gjithashtu janë vetëm në gjuhën shqipe.

Deputetët boshnjakë informohen përmes programit të RTK-së, shtypit ditor dhe përmes internetit.

*Besojmë se ligji mbi përdorimin e gjuhëve dhe ligji kundër diskriminimit do të zbatohen më mirë pas zgjedhjes së statusit të Kosovës, të bazuar në planin e Marti Ahtisarit.*

**Xh. M. boshnjak, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 25 janar 2008

#### 4. Deputetët romë në Kuvendin e Kosovës

Shqetësimi kryesor për deputetët romë në Kuvendin e Kosovës është ruajtja e identitetit të tyre. Ligji mbi përdorimin e gjuhëve fare nuk po respektohet kur bëhet fjalë për gjuhën rome. Gjuha rome nuk është gjuhë amtare në asnjë komunë. Nga fakti se në Kosovë nuk ekzistojnë shkolla në të cilat romët mund ta ndjekin mësimin në gjuhën e tyre, ata vijojnë shkollat në gjuhën shqipe, në kompetencë të Qeverisë së Kosovës ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, ose në shkollat në kompetencë të Qeverisë së Serbisë, ku mësimi mbahet në gjuhën serbe. Në këtë mënyrë romët rrezikohen ta humbin identitetin e tyre.

*Nëse një komb nuk e flet gjuhën e vet për dhjetë vjet, atëherë ajo bashkësi shkon drejt asimilimit. Paramendoni, vetëm në Prizren jetojnë 5500 romë, 13 romë janë të punësuar në SHPK, por vetëm dy nga ata flasin gjuhën rome.*

**H.Z.M, rom, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 25 janar 2008

Në komunikim me zyrtarët komunal romët përdorin gjuhën serbe ose shqipe. Dokumentacionin të cilin pranojnë nga komunat është në gjuhën shqipe ose serbe, varësisht se në cilën gjuhë romët e kanë bërë kërkesën.

Problem tjetër për romët janë edhe zyrtarët për komunitete të cilat janë jofunksionale, sepse përfaqësuesit e tyre nuk i mbrojnë interesat e bashkësive pakicë por interesat e partive politike anëtarë të cilave u takojnë. Romët angazhohen që drejtorët e këtyre zyrave të zgjidhen përmes konkursit, e jo të jenë rezultat i marrëveshjeve politike.

Deputetët romë pohojnë se 80 për qind e romëve që jetojnë në Kosovë, mësimin e ndjekin në gjuhë shqipe, 8 për qind në gjuhën turke dhe 6 për qind në atë serbe. Vetëm një numër i vogël i romëve studiojnë në Kosovë. Ata të cilët studiojnë, këtë e bëjnë në fakultetet shtetërore. Në Kosovë funksionon një numër i madh i fakulteteve private, por romët nuk i gjejnë atje sepse vijimi i këtyre fakulteteve kushton shumë dhe romët nuk kanë mundësi të paguajnë.

Romët nuk janë të kënaqur me shërbimet e disa ndërmarrjeve publike. Kjo para së gjithash ka të bëjë me lagjen e romëve në Mitrovicën/Mitrovica jugore dhe kampin të Plemetinit/Plemetin, sepse kjo lagje akoma

nuk është e lidhur me sistemin e ujësjellëdit dhe kanalizimit, dhe nuk kanë as lidhje telefonike.

Deputetët romë në radhë të parë informohen përmes RTK-së dhe mediave të shkruara, por edhe përmes internetit.

Ata thone se nuk ka romë të punësuar në pozita udhëheqëse në Kuvendin e Kosovës, dhe nuk ka asnjë rom të punësuar në banka, PTK ose KEK në Kosovë.

## 5. Deputetët egjiptas në Kuvendin e Kosovës

Egjiptasit gëzojnë lirinë e plotë të lëvizjes në Kosovë. Gjuha e tyre amtare është gjuha shqipe, çka u ka mundësuar atyre që më lehtë se bashkësitë tjera të integrohen në shoqërinë kosovare. Ata janë të kënaqur me shërbimet të cilat ofrohen në komunat, shtëpitë e shëndetit dhe ndërmarrjet publike në Kosovë. Megjithatë, deputetët egjiptas janë të mendimit se jo të gjitha ligjet me interes për pakicat zbatohen në mënyrë të kënaqshme.

Në Pejë/Peć, në shkollat ku fëmijët egjiptas vijnë mësimin organizata të ndryshme humanitare shpërndajnë fletore, ngjyra dhe lapsa. Edhe pse janë të varfër, egjiptasit nuk e miratojnë një veprim të tillë, por këtë formë të ndihmës humanitare e shohin si nënçmim, ofendim dhe formë të getoizimit. Në Universitetin e Prishtinës/Prishtina për momentin studiojnë 60 studentë egjiptas.

Problemi më i madh për egjiptasit është se pjesa më e madhe e pjesëtarëve të kësaj bashkësie etnike janë të papunë. Këta deputetë pohojnë se, për shembull, asnjë egjiptas në Pejë/Peće, nuk punon në KEK ose PTK. Egjiptasit janë të mendimit se bashkësitë tjera etnike në Kosovë janë më të privileguara në raport me ata.

*Në Pejë, egjiptasit janë të punësuar në zyrën për komunitete. Në SHPK punojnë gjithsej 10 egjiptas. Shumë institucione dhe ndërmarrje publike gjatë procesit të punësimit, egjiptasit i grupojnë në grup me shqiptarët. Pakicat në Kosovë nuk trajtohen njësoj. Serbët dhe boshnjakët janë të privileguar. Vendet e lira të punës ruhen për këto komunitete.*

**Xh. N. egjiptas, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë e FDH-së, 25 janar 2008

Egjiptasit informohen kryesisht përmes RTK-së, kurse një pjesë e tyre edhe përmes internetit.

## 6. Deputetët goranë në Kuvendin e Kosovës

Numri më i madh i goranëve jeton në komunën e Dragashit/Dragaš. Gjatë komunikimit të përditshëm me institucionet e Kosovës dhe ndërmarrjet publike ata flasin në gjuhën serbe. Mes vete flasin në gjuhën gorane, e cila nuk është gjuhë zyrtare, sepse nuk është e standardizuar. Pjesa tjetër e komunitetit goran deklarohet si boshnjak dhe flet në gjuhën boshnjake. Këto dy grupe të goranëve janë në konflikt të vazhdueshëm mes vete. Goranët nuk janë të kënaqur me punën e Qeverisë së Kosovës dhe mendojnë se shqiptarët janë përgjegjës për pozitën në të cilën ndodhen pakicat si dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare, meqenëse janë shumicë.

*Problemin më të madh e kemi me boshnjakët. Ata duan që gjithçka të jetë vetëm në gjuhën boshnjake. Fëmijët tanë duhet ta vijnë shkollën në gjuhën boshnjake nëse duan të jenë pjesë e sistemit të MASHT-it. Ne nuk e pranojmë këtë. Për ne është më mirë që fëmijët tanë të mësojnë në gjuhën shqipe, gjuhë të cilën ata nuk e kuptojnë, se sa në gjuhën boshnjake. Goranët deklarohen si boshnjakë për të gjetur ndonjë vend pune.*

**M.H. goran, deputet në Kuvendin e Kosovës**  
Intervistë FDH-së, 25 janar 2008

Goranët kanë lirinë e plotë të lëvizjes si në Dragash/Dragaš ashtu edhe në tërë territorin e Kosovës. Përkundër kësaj, ata shumë rrallë udhëtojnë jashtë komunës. Kur vendosin të udhëtojnë, këtë e bëjnë lirshëm, me vetura private dhe me furgonët e goranëve.

Me organet komunale të Dragashit/Dragaš shumica e goranëve përdorin gjuhën serbe. Zyrtarët shqiptarë u përgjigjen në gjuhën në të cilën palët u drejtohen atyre. Dokumentacioni i marrë lëshohet në gjuhën serbe/boshnjake dhe në atë shqipe. Marrëdhëniet me SHPK-në janë përgjithësisht korrekte, por ka pasur raste kur thirrja për t'u marrë në pyetje në stacionin policor është dërguar në gjuhën shqipe.

Në Shtëpinë e shëndetit janë të punësuar mjek të nacionalitetit goran dhe shqiptar. Raporti mjek-pacient është i mirë. Formularët, udhëzimet, recetat

dhe fletët e laboratorit janë në gjuhën shqipe dhe serbe, varësisht nga përkatësia etnike e pacientit.

Shumica e nxënësve goranë ndjekin mësimet në shkollat të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Serbisë. Momentalisht, 30 studentë goranë studiojnë në fakultetin e Mitrovicës/Mitrovica veriore.

Qytetarët e Dragashit/Dragaš jetojnë në terr informativ. Në Gorë nuk arrijnë valët e RTK-së, megjithatë, goranët janë të detyruar ta paguajnë taksën për RTK-në në kuadër të faturës për rrymë, edhe pse nuk mund t'i përcjellin programet e këtij televizioni.

Në tabelën e shpalljeve mund të gjenden informata për vendet e lira të punës në komunë, por jo edhe për vendet e punës në institucionet tjera. Goranëve, në veçanti, ju pengon që nuk mund të gjejnë vende të lira të punës në KEK dhe PTK. Në përgjithësi, qytetarët e Gorës nuk janë të njoftuar për ekzistimin e ligjeve që garantojnë të drejtat themelore të pakicave. Goranët janë të mendimit se fushata për informimin e qytetarëve në lidhje me këto ligje është e domosdoshme.

Në Gorë janë të shpeshta restriksionet e rrymës. Goranët thonë se faturat e KEK-ut janë në tri gjuhë shqip, serbisht dhe anglisht, por dëftesat për pagesë janë vetëm në gjuhën shqipe. PTK-ja akoma nuk ka vendosur rrjetin e telefonisë fikse.

## Rekomandime

- Qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje më të mëdha, në mënyrë që të përmirësohet pozita e komuniteteve pakicë në Kosovë dhe të respektohet e drejta e tyre për punësim, përdorim të gjuhës amtare në jetën e përditshme dhe arsimim në gjuhët e pakicave. Përmes respektimit të këtyre të drejtave, do të krijohen kushtet për siguri dhe për integrimin e të gjitha komuniteteve etnike në shoqërinë kosovare.
- Qeveria e Kosovës duhet t'i përfshijë pjesëtarët e pakicave në proceset e vendimmarrjes për mirëqenien e gjithë qytetarëve të Kosovës, në nivel lokal dhe qendror. Qeveria e Kosovës, posaçërisht duhet t'i përfshijë pjesëtarët e pakicave në proceset e vendimmarrjeve, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave të pakicave, siç është për shembull liria e lëvizjes, përdorimi i gjuhëve, shkollimi në gjuhën amtare dhe punësimi.
- Hulumtimi i FDH – Kosovë ka treguar se të gjitha komunitetet në Kosovë, duke përfshirë edhe shqiptarët, janë të pakënaqur me punën e zyrave për komunitete, për faktin se drejtorët e këtyre zyrave zgjidhen sipas marrëveshjeve mes partive. Qeveria e Kosovës duhet të mundësojë që përfaqësuesit e këtyre zyrave të zgjidhen në bazë të meritave dhe me proces transparent rekrutimi. Të gjitha komunitetet etnike janë të mendimit se vetëm në atë mënyrë zyra për komunitete do të jetë e suksesshme në punën e saj, për përmirësimin e pozitës së të gjitha bashkësive pakicë në Kosovë.
- Qeveria e Kosovës dhe institucionet lokale urgjentisht duhet të fillojnë fushatën e përgjithshme për informimin e qytetarëve të Kosovës dhe të punësuarve në institucionet publike, mbi detyrimet që kanë organet dhe institucionet e Kosovës në bazë të ligjit për përdorimin e gjuhëve.
- Gjatë procesit të informimit të qytetarëve, Qeveria e Kosovës duhet në radhë të parë t'i kushtojë vëmendje informimit të komuniteteve pakicë, në mënyrë që t'i njoftojë ata me të gjitha instrumentet ligjore që kanë në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre.
- Të gjitha institucionet e Kosovës dhe ndërmarrjet publike duhet të përkthejnë gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhët zyrtare të Kosovës.

- Ndërmarrjet publike në ato komuna, ku përpos gjuhëve zyrtare në Kosovë statusin e gjuhëve zyrtare e kanë edhe gjuhët tjera, duhet që gjithë dokumentacionin e tyre ta përkthejnë edhe në ato gjuhë.
- Të gjitha institucionet kosovare dhe ndërmarrjet publike, duhet që dokumentacionin e tyre ta lëshojnë në gjuhët zyrtare. Në komunat ku përpos gjuhëve zyrtare në Kosovë, në përdorim zyrtar janë edhe gjuhët tjera, institucionet kosovare dhe ndërmarrjet publike duhet ta lëshojnë dokumentacionin edhe në ato gjuhë.
- Gjatë përgatitjes së dokumenteve të cilat institucionet kosovare dhe ndërmarrjet publike ua dorëzojnë qytetarëve me kërkesë të këtyre të fundit, zyrtarët e institucioneve duhet t'i respektojnë rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore të gjuhës në të cilën lëshohet dokumenti.
- Komisioni për gjuhët, që është themeluar në bazë të ligjit për përdorimin e gjuhëve, duhet të monitorojë në mënyrë më aktive zbatimin e ligjit, të tregojë të metat dhe të ndërmarrë të gjitha masat në përputhje me ligjin.
- MASHT-i i Kosovës duhet të përpilojë plan-programin sipas të cilit do të zhvillohej mësimi në gjuhën serbe, për fëmijët serbë dhe fëmijët e pakicave tjera, që duan të vijojnë mësimin në këtë gjuhë. Me përfshirjen e fëmijëve serbë dhe të pakicave tjera, që aktualisht mësimin e ndjekin në shkollat serbe, krijohen kushte për integrimin e tyre në shoqërinë e re kosovare.
- MASHT-i i Kosovës e ka për detyrë që, brenda afatit më të shkurtër të mundshëm kohor, t'u krijojë kushte fëmijëve romë të arsimohen në gjuhën e tyre amtare, gjë që është në përputhje edhe me Kornizën kushtetuese të Kosovës dhe ligjin mbi përdorimin e gjuhëve.
- MASHT-i i Kosovës e ka për detyrë të sigurojë libra shkollorë për nxënësit e shkollave të mesme nga komunitetet pakicë, të cilët mësimin e ndjekin sipas plan programeve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të gjitha librat shkollorë që mungojnë për lëndët në shkollimin fillorë.
- Institucionet e Kosovës duhet të krijojnë kushte në mënyrë që pakicat të mund të punësohen në ndërmarrjet publike dhe private.
- Përqindja e të punësuarve nga radhët e komuniteteve pakicë në ndërmarrjet publike, duhet të pasqyrojë strukturën etnike të regjionit në të cilin ndërmarrja e caktuar publike kryen aktivitetin e saj. Në rastin e kompanive, siç është Aeroporti i Prishtinës/Priştina, përqindja e të punësuarve nga radhët e komuniteteve pakicë, duhet të pasqyrojë strukturën etnike të Kosovës.
- Qeveria e Kosovës duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat, në mënyrë që ta ndërpresë praktikën sipas të cilës mosnjohja e gjuhës shqipe ka për pasojë refuzimin e kandidatit nga radhët e komuniteteve pakicë për vendin e caktuar të punës.
- Qeveria e Kosovës duhet që të organizojë kurse të gjuhës shqipe në të gjitha nivelet, për pjesëtarët e komuniteteve pakicë.
- Ndërmarrja publike Kosovatransi dhe transporti urban në Kosovë, duhet të vendosin lidhje të rregullta të autobusëve edhe për në enklavat serbe në Kosovën qendrore, jugore dhe veriore.
- Qeveria e Kosovës duhet që, brenda afatit më të shkurtër të mundshëm, të rivë në qarkullim »Trenin e lëvizjes së lirë» në mënyrë që t'iu mundësohet serbëve që të udhëtojnë lirisht nëpër gjitha pjesët e Kosovës dhe në Serbi.
- Valët e RTK-së duhet të mbulojnë gjithë territorin e Kosovës.
- Mediat e Kosovës duhet të jenë shumë më të hapura ndaj komuniteteve pakicë, të transmetojnë programe në gjuhët e pakicave, dhe gjuhën shqipe gjë që popullarizon multi-etnicitetin e Kosovës.
- SHPK-ja duhet t'i hetojë të gjitha rastet e dhunës së motivuar etnikisht, të punojë në mënyrë më efektive në zbulimin e kryerësve, si dhe të bëjë të qartë se çfarë ka zbuluar gjatë hetimit, në mënyrë që të shmangen spekulimet dhe politizimi i rasteve.

